

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6060
E shtunë, 11 korrik 2020
çmimi 0.40 €

Gjermania i dhuron Kosovës 6 000 teste për Covid-19



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", VALON MURATI

KOSOVËS I DUHET NJË QEVERI E UNITETIT KOMBËTAR

Kryetari i Lëvizjes për Bashkim, Valon Murati, ka bërë me dije se në këtë kohë zgjidhja më e mirë për Kosovën do të ishte formimi i një qeverie të unitetit kombëtar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo qeveri do të duhej ta udhëhiqte vendin deri në përfundimin e dialogut me Serbinë dhe realizimin e një reforme zgjedhore. Murati ka thënë se e vetmja mënyrë

për ta larguar tërësisht Serbinë nga Kosova është projekti i ripërcaktimit të kufijve, të cilën Lëvizja për Bashkim e ka shndërruar në platformë politike që në vitin 2010. Ai ka vlerësuar se qeveria aktuale është e brishtë, duke theksuar se kriza politike e brendshme, e përcjellë me pandeminë në rritje dhe krizën ekonomike në anën tjetër, po ia bën të vështirë jetën kësaj qeverie



OPINION

A MOS JANË EDHE VETË EVROPIANËT QË PAGUHEN PËR KOSOVËN INFORMATORË TË SHPIFJEVE TË DICK MARTYT DHE SHPIFËS PËR TA NJOLLOSUR LUFTËN E KOSOVËS PËR ÇLIRIM? F. 11

Shkruan:
Kudusi LAMA



GJYKATA SPECIALE, PËRCAKTUESE E BISEDIMEVE MIDIS SERBISË DHE KOSOVËS F. 6

Nga: KMDLNj

AKTUALE

MUSTAFA DEL POZITIV ME COVID-19 F. 2

NISMA SOCIALDEMOKRATE: TË GJITHA PËRPEKJET DASHAKEQE KUNDËR NESH DO TË DËSHTOJNË F. 6

EKONOMI

KLUBI I PRODHUESVE: PROCESI I RIMËKËMBJES EKONOMIKE TË FOKUSOHET PËRMES PËRKRAHJES SË PRODHIMIT F. 9

MINISTRJA BAJRAMI SHPALOS PLANET PËR PËRKRAHJEN E SEKTORIT PRIVAT PAS PANDEMISË F. 8

KULTURË

FUNKSIONALIZOHEN NËNKODET BUXHETORE PËR INSTITUCIONET KOMBËTARE TË KULTURËS E TË TRASHËGIMISË F. 2

HOTI NË SAMITIN E PARISIT: PA NJOHJE RECIPROKE NUK KA MARRËVESHJE ME SERBINË



Nën ndërmjetësimin e Francës, Gjermanisë dhe BE-së është mbajtur samiti virtual ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në këtë samit, që shënon takimin e parë ndërmjet përfaqësuesve politikë të Kosovës dhe Serbisë, palët i kanë prezantuar objektivat e këtij procesi. Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se procesi duhet të këtë afate kohore dhe të përfundojë me njohje reciproke. Ndërsa presidenti i Serbisë, kërkesat e Kosovës i ka quajtur të pakuptimta

tuar objektivat e këtij procesi. Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se procesi duhet të këtë afate kohore dhe të përfundojë me njohje reciproke. Ndërsa presidenti i Serbisë, kërkesat e Kosovës i ka quajtur të pakuptimta

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Funksionalizohen nënkodet buxhetore për institucionet kombëtare të kulturës e të trashëgimisë



PRISHTINË, 10 KORRIK (ER) - Funksionalizohen nënkodet buxhetore për institucionet kombëtare të kulturës e të trashëgimisë të cilat janë në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Kjo gjë ua mundëson institucioneve në fjalë që vetë ato ta menaxhojnë buxhetin që ministria ndan për to. Ky është një fillim i procesit të pavarësimit të institucioneve vartëse në aspektin

administrativ. Institucionet vartëse, përmes zyrtarëve përkatës të trajnuar dhe të certifikuar, vetë do të mund t'i zotojnë dhe shpenzojnë mjetet financiare në bazë të planit dhe programit të paraparë, ndërsa MKRS-ja bën vetëm certifikimin e shpenzimeve. Me këtë rast, ministrja Vlora Dumoshi e ka vlerësuar këtë si një proces konform ligjit dhe rekomandimeve, i cili institucioneve ua mundëson

një performancë më të mirë dhe redukton procedurat burokratike. Pa nënkode buxhetore institucionet vartëse të trashëgimisë dhe të kulturës kanë pasur sfida të theksuara në aspektin e menaxhimit e vet institucioneve, por tashmë pas funksionalizimit të nënkodeve, MKRS-ja do të kërkojë më shumë përgjegjësi në raport me mandatet e institucioneve.

Reforma zgjedhore në Shqipëri, në udhëkryq

TIRANË, 10 KORRIK - Në Shqipëri ende mbetet e komplikuar zgjidhja për miratimin e reformës zgjedhore. Ndërsa shumica deklaroi se do t'i përmbahet marrëveshjes së arritur me Partinë Demokratike dhe LSI-në, ajo nuk i ka votat për miratimin e saj. E gjendur nën trysninë e deputetëve të opozitës parlamentare, ashtu siç deklaroi dy ditë më parë kryeministri Edi Rama, edhe kryetari i grupit socialist Taulant Balla ka ripërsëritur se shumica është e gatshme të diskutojë për hapjen e listave, një prej kërkesave të deputetëve të opozitës.

Nga ana e saj, Partia Demokratike ka deklaruar se nuk është kundër rishikimit të sistemit, por se nuk është ky momenti për ta bërë këtë, duke paralajmëruar se nuk do të pranojë asnjë veprim të njëanshëm "Ne do të çojmë përpara edhe marrëveshjen me opozitën jashtëparlamentare e duam të çojmë përpara dhe një marrëveshje me ju, në kuadër të atyre çfarë ju keni propozuar, ku

ajo që është më e rëndësishme, t'i japim mundësi çdo qytetari që, përveç logos dhe liderit të partisë, të votojë edhe një preferencë unike për një prej deputetëve që ai preferon të jetë në parlamentin e ardhshëm të Shqipërisë", ka thënë Taulant Balla. Ai duke iu drejtuar deputetëve të opozitës tha: "Politika është art i konsensusit. Ju duhet ta jepni konsensusin tuaj sa i përket kodit dhe ne padyshim jemi të gatshëm t'ju japim konsensusin", ka thënë ai.

Por për kreun e grupit demokrat në parlament, Myslim Murrizi, "socialistët kanë sikletin që duan ta kenë mirë me të gjitha palët". Deputetët e opozitës nuk e njohin marrëveshjen e arritur nga shumica me PD-në dhe LSI-në. "Një marrëveshje e ndërtuar mes një deputeti të shumicës dhe dy qytetarëve të zakonshëm nuk mund t'i detyrojë deputetët e opozitës. Ne kemi kërkuar lista të hapura kombëtare dhe votim 100 për qind pa asnjë ndryshim të rekomandimeve të OSBE-së. Kemi kërkuar që të ketë prag zgjedhor



që askush të hipë në kurriz të askujt. Kemi kërkuar që votat, për herë të parë pas 30 vjetësh, të numërohen jo nga militantët politikë", u shpreh Murrizi. Nga ana e saj, Partia Demokratike bëri me dije se çështja e listave të hapura nuk mund të diskutohet në këto çaste, duke paralajmëruar se çdo

veprim i njëanshëm do të ishte me pasoja. Sipas Partisë Demokratike, "hapja në këtë moment, e diskutimit për sistemin zgjedhor, është vetëm alibi e Edi Ramës për ta vonuar kodifikimin në parlament të dakordësisë së 5 qershorit, që është një kërkesë e sekretarit amerikan të Shtetit, Mike Pompeo,

si dhe 1 nga 15 kushtet për nisjen e negociatave të anëtarësimit me BE-në. Çdo veprim i njëanshëm në këtë drejtim do të përbente prishje të marrëveshjes konsensuale të 5 qershorit, me pasoja për vendin dhe të ardhmen evropiane të Shqipërisë", thuhet në reagimin e Partisë Demokratike.

Xhaçka dhe Kim vizitojnë Bazën Detare të Pashalimanit: Mundësi transformimi në një projekt të NATO-s



TIRANË, 10 KORRIK - Ministrja e Mbrojtjes së Shqipërisë, Olta Xhaçka, së bashku me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Yuri Kim, ka zhvilluar një vizitë në Bazën Detare të Pashalimanit, ku po vlerësohet mundësia e modernizimit dhe transformimit në një projekt model të NATO-s. "Me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Yuri Kim, zhvilluam një vizitë në Bazën Detare të Pashalimanit, për të cilën bashkë me Aleancën po vlerësojmë mundësinë e modernizimit dhe transformimit në një

projekt model të NATO-s. Me pas, një udhëtim i shkurtër në Gjirin e Vlorës u mundësua nga anija Butrinti P-134, e cila ka marrë pjesë disa herë në operacionin 'Sea Guardian' të NATO-s në detin Egje, duke shpëtuar me qindra emigrantë. Me aleatin tonë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ndajmë jo vetëm misione të rëndësishme në teatrot operacionale, por edhe qëllimin e përbashkët për modernizimin e Forcave tona të Armatosura", ka shkruar ministrja Xhaçka në llogarinë e vet në "Facebook".

Mustafa del pozitiv me Covid-19

PRISHTINË, 10 KORRIK - Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka njoftuar se ka dalë pozitiv me Covid-19. Në një njoftim publikuar në llogarinë e vet në "Facebook", Mustafa ka shkruar se,

përveç plogështie, nuk ka ndonjë shqetësim tjetër shëndetësor. "Sot, pas analizave të kryera, kam rezultuar pozitiv me Covid-19. Përveç një plogështie, nuk vërej ndonjë

shqetësim tjetër shëndetësor. Anëtarët e tjerë të familjes nuk janë të prekur. Ditët në vijim do të jem i izoluar. Apeloj te të gjithë për kujdes maksimal!", ka shkruar Mustafa.



Hoti në Samitin e Parisit: Pa njohje reciproke nuk ka marrëveshje me Serbinë

Nën ndërmjetësimin e Francës, Gjermanisë dhe BE-së është mbajtur samiti virtual ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në këtë samit, që shënon takimin e parë ndërmjet përfaqësuesve politikë të Kosovës dhe Serbisë, palët i kanë prezantuar objektivat e këtij procesi. Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se procesi duhet të ketë afate kohore dhe të përfundojë me njohje reciproke. Ndërsa presidenti i Serbisë, kërkesat e Kosovës i ka quajtur të pakuptimta

vendosmëri se dialogu duhet të ndjekë një afat kohor dhe kornizë të qartë të vlerave themelore dhe parimeve që duhen respektuar, në përputhje me perspektivën evropiane të të dy vendeve. Ne besojmë se sukcesi i këtij procesi thelbësor duhet të udhëhiqet nga parimet", ka thënë Hoti, duke i përmendur parimet. "Integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i panegociueshëm, pasi është premisa kryesore mbi të cilën themelohet Republika e Kosovës dhe qëndron fort. Çdo shkelje shkon kundër parimeve dhe vlerave themelore të BE-së. Si i tillë, është i papranueshëm. Organizimi kushtetues i Republikës së Kosovës nuk mund të ndikohet pasi garanton funksionimin demokratik të autoriteteve, barazinë në përfaqësim dhe mishëron parimin e shtetit qytetar, dhe jo të organizuar përgjatë linjave etnike. Prandaj,

ndërhyrja në karakterin unitar të Republika e Kosovës do të ishte mënyra më e shkurtër për ta defunksionalizuar shtetin e Kosovës dhe për ta shpallur atë të paqëndrueshme. Kjo nuk mund të ndodhë", ka thënë Hoti. Sipas tij, marrëveshja me Serbinë duhet të jetë plotësisht në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, pasi që është i vetmi modalitet për t'i dhënë legjitimitet një marrëveshje të tillë. Bazuar në këto parime, ai ka thënë Kosova do të angazhohet në dialog me objektiva të qarta. "Marrëveshja gjithëpërfshirëse e paqes midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë duhet të rezultojë në njohje reciproke. Pa një përfundim të tillë të këtij procesi Marrëveshja nuk mund të ketë sukses. Njohja e ndërsjellë midis dy vendeve është mënyra e vetme për t'i normalizuar marrëdhëniet dhe shtruar rrugën për të dy vendet

për integrimin në BE. Rezultat i kësaj marrëveshje duhet të jetë, gjithashtu, detyrimi i BE-së për ta përfshirë njohjen e Kosovës nga pesë vendet e mbetura të BE-së", është shprehur ai, duke shtuar se anëtarësimi i Kosovës në Kombet e Bashkuara duhet të jetë pjesë e rezultatit të marrëveshjes gjithëpërfshirëse të paqes në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Kjo natyrisht nënkupton zëvendësimin e Rezolutës 1244 të Sigurimit të Kombet e Bashkuara. Ndjekja e anëtarësimit në organizata të tjera ndërkombëtare dhe hapja e qartë e perspektivës evropiane për Kosovën është objektiv i ynë dhe apeli ynë krahas këtij procesi. Dhe e fundit, por jo nga rëndësia, personat e zhdukur dhe viktimat e të gjitha formave të dhunës, viktimat e dëmeve të luftës, janë çështje e shqetësimit tonë maksimal në këtë proces. Asnjë normalizim nuk mund të bëhet përpara vendosjes së drejtësisë", ka thënë Hoti.

Kurse presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, kërkesat e Kosovës i ka quajtur të pakuptimta. "Pala shqiptare doli me kërkesa që i shënuam me kujdes. Ata kërkojnë ruajtjen e integritetit territorial të Kosovës, Kushtetutës së Kosovës, njohje të ndërsjellë, anëtarësim në Kombet e Bashkuara, që vendet e tjera të Bashkimit Evropian ta njohin Kosovën dhe pastaj do të merreshin me të zhdukurit dhe çështjen e dëmeve. Nëse ky është thelbi, atëherë gjithçka është e pakuptimtë", ka thënë Vuçiqi pas takimit.

Në samitin virtual kanë marrë pjesë presidenti francez Emmanuel Macron, kancelarja gjermane Angela Merkel, përfaqësuesi i lartë i BE-së për Punët e Jashtme, Josep Borell dhe i dërguari i posaçëm për Ballkanin Perëndimor, Miroslav Lajčak.

EPOKA ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 10 KORRIK - Samiti i paralajmëruar për një kohë të gjatë nga Franca dhe Gjermania me udhëheqësit e Kosovës dhe Serbisë është zhvilluar virtualisht të premtën. Ky samit, në të cilin palët i kanë prezantuar qëndrimet e veta, ka shënuar rifillimin e dialogut të BE-së për normalizimin e marrëdhënieve, i cili është ndërprerë në fund të vitit 2018. Samitin e ka hapur presidenti i Francës, Emmanuel Macron, i cili ka thënë se kthimi në negociata është i domosdoshëm. "Rezultate substanciale janë arritur për dhjetë vjet me ndërmjetësimin e BE-së. Duhet të ketë një zgjidhje përfundimtare dhe ligjore", është shprehur Macron. Ai ka deklaruar se BE-ja është e përfshirë në këtë proces, duke shtuar se stabiliteti i Ballkanit është përgjegjësi e Bashkimit Evropian. "Dialogu është në interes të të gjithëve. Ka situatë të paqëndrueshme me shumë rreziqe dhe jostabilitet", ka thënë presidenti francez. Kryeministri Avdullah Hoti në fjalimin e tij ka shpalosur parimet kryesore mbi të cilat do të zhvillohet rifillimi i dialogut për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës e Serbisë. Ai ka thënë

se që nga fillimi i dialogut në vitin 2011 Serbia ka vazhduar të ndërmarrë fushata kundër anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe duke lobuar kundër njohjes së Republikës së Kosovës nga shtetet e tjera.

Hoti ka vlerësuar se praktikrat e tilla të dëmshme kanë dëmtuar procesin e normalizimit të marrëdhënieve mes dy vende të pavarura. "Ne besojmë me



Mbahet testi i maturës për nxënësit që janë pranuar në universitetet ndërkombëtare

Prishtinë, 10 korrik - Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka organizuar sot Provimin e Maturës për nxënësit të cilët janë pranuar në universitetet jashtë Kosovës dhe u janë kërkuar edhe pikët në testin e

maturës. Me vendim të Këshillit Shtetëror të Maturës (KShM), provimi është mbajtur për 103 nxënësit të paraqitur për të hyrë në testin e maturës, e që si dëshmi e kanë pasur dokumentin e pranimit

në universitete ndërkombëtare.

Testimi i këtyre maturantëve është organizuar në dy qendra: në shkollën "Xhevdet Doda" në Prishtinë, ku janë testuar 61 nxënësit nga disa

rajone të Kosovës dhe në shkollën "Gjon Buzuku" në Prizren, ku testit i janë nënshtruar 42 maturantë nga kjo komunë.

Provimin e Maturës për këta nxënësit ka shkuar sipas plani-

fikimit dhe duke i respektuar të gjitha masat e rekomanduara nga IKShP dhe MSh për mbrojtje nga virusi Covid-19. Rezultatet për nxënësit e testuar të premtën do të bëhen publike më 13 korrik.

FLET PËR “EPOKËN E RE”, VALON MURATI

KOSOVËS I DUHET NJË QEV

Kryetari i Lëvizjes për Bashkim, Valon Murati, ka bërë me dije se në këtë kohë zgjidhja më e mirë për Kosovën do të ishte formimi i një qeverie të unitetit kombëtar. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se kjo qeveri do të duhej ta udhëhiqte vendin deri në përfundimin e dialogut me Serbinë dhe realizimin e një reforme zgjedhore. Murati ka thënë se e vetmja mënyrë për ta larguar tërësisht Serbinë nga Kosova është projekti i ripërcaktimit të kufijve, të cilën Lëvizja për Bashkim e ka shndërruar në platformë politike që në vitin 2010. Ai ka vlerësuar se qeveria aktuale është e brishtë, duke theksuar se kriza politike e brendshme, e përcjellë me pandeminë në rritje dhe krizën ekonomike në anën tjetër, po ia bën të vështirë jetën kësaj qeverie

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 10 KORRIK -

“Epoka e re”: Z. Murati, si e keni parë publikimin e aktakuzës nga Gjykata Speciale për z. Thaçi dhe z. Veseli ende pa u konfirmuar ajo?

Murati: Unë kam qenë jashtëzakonisht i habitur qoftë me kohën e publikimit, edhe me shumë me përmbajtjen e saj. Koha e publikimit të njoftimit nga ana e Zyrës së Prokurorit Special për ngritjen e aktakuzave për presidentin e vendit, z. Thaçi dhe kryetarin e PDK-së, z. Veseli, ishte jashtëzakonisht e çuditshme. Duke qenë një moment kohor që korrespondonte me nisjen e presidentit për takimin e 27 qershorit në Shtëpinë e Bardhë me palën serbe, sigurisht se e hapi derën për shumë spekulime. Rrjedhimisht, publikimi i aktakuzës ndikoi në dështimin e mbajtjes së këtij takimi. Në anën tjetër, deklarata e ZPS-së kishte probleme të thella edhe në përmbajtjen e saj. Zakonisht institucionet e drejtësisë, sidomos të drejtësisë ndërkombëtare (sado që Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit Special formalisht janë pjesë e sistemit tonë juridik), kanë një gjuhë jashtëzakonisht profesionale dhe të përpunuar në aspektin juridik dhe nuk lënë hapësirë për spekulime politike. Kjo letër i përngjante më shumë një pamflet politik të shkruar në zyrat e partive politike diku në Ballkan sesa një njoftim të një mekanizmi të drejtësisë. Përmbajtja e letrës kishte shumë probleme me konotacionin e saj politik, por edhe duke e shkelur rëndë parimin e prezumimit të pafajësisë të dy të apostrofuarve, të cilat deri më tani janë analizuar në opinionin publik. E, mbi të

gjitha, bërja publike e aktakuzës pa u konfirmuar nga gjykatësi i procedurës paraprake, është në kundërshtim me Rregullën 88 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës. Kjo e bën punën e këtij institucioni jokredibil në sytë e opinionit e sidomos kur duket qartazi që ZPS me këtë pamflet politik ka pasur më shumë qëllim të ndikojë drejtpërdrejt në procese politike sesa t'i shërbejë drejtësisë. Kjo, thënë më së buti, është skandaloze dhe po na fut në të panjohura e në befasi politike të vazhdueshme.

“Epoka e re”: Publikimi i kësaj aktakuze pak ditë para takimit të Uashingtonit u pa si veprim i ndikuar nga rivaliteti që kanë ShBA-ja dhe BE-ja në procesin e dialogut Kosovë - Serb. A ka bazë një analizë e tillë?

Murati: Një kundërthënie e lehtë në mes të ShBA-së dhe BE-së, apo shteteve kryesore të saj, gjithmonë ka ekzistuar. Por vitet e fundit kjo kundërthënie ka shkuar duke u rritur. Sigurisht se kundërthëniet e tilla e vënë në pozitë të palakmueshme Kosovën, duke pasur parasysh se Kosova synon anëtarësimin në BE në njërin anë, por në anën tjetër e konsideron ShBA-në aleatën kryesore. Tani e një kohë ne kemi një situatë të tensionuar edhe në raport me dialogun, ku duket se kemi një garë në mes të ShBA-së dhe BE-së për çështjen e dialogut. Ajo që dihet është se BE-ja ka mandat edhe nga Këshilli i Sigurimit që prej vitit 2011 që ta lehtësojë dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. Dhe mospërfshirja e ShBA-së është bërë me qëllim që të mos lejohet edhe përzierja ruse në këto bisedime. Sidoqoftë, si atëherë e si sot është e qartë se kur të vijë te finalja e një

marrëveshjeje politike, do të jetë e vështirë pa përfshirjen e drejtpërdrejtë të ShBA-së sepse ajo është i vetmi shtet që ka forcë politiko-ekonomike dhe potencial ushtarak jo vetëm për t'i bindur palët, por edhe për ta implementuar marrëveshjen. Ajo çfarë ndodhi me publikimin e aktakuzës dhe dështimin e takimit të Uashingtonit ka krijuar mundësitë për shumë spekulime. Sidoqoftë, vetëm e ardhmja dhe proceset e ardhshme politike do të na mundësojnë që gradualisht të kuptojmë se krejt kush kishte gisht në publikimin e aktakuzës në mënyrë që të shkaktonte një kaos të tillë politik, e që do të ndikonte në dështimin e takimit të 27 qershorit. Tash me këto zhvillimet e reja, por edhe me zvarritjen që ia kemi bërë vetes për dy vjet, dialogut me mostrajtimin serioz të përkushtimit të kësaj administrate amerikane për ta përmbyllur dialogun, duket se procesi i dialogut do të jetë më i gjatë sesa që ka mundur të jetë. Megjithatë, siç e theksova edhe më lart, jam i bindur se pa marrë parasysh se çfarë do të ndodhë me procesin e dialogut, përfshirja e ShBA-së në fazën finale do të jetë e domosdoshme. Në anën tjetër, ka gjasa që së shpejti, pas samitit virtual që u zhvillua në Paris dhe pas takimit të Brukselit, do ta kemi edhe një takim në Uashington me temën e ekonomisë. Personalisht tani nuk pres marrëveshje të shpejtë, por më shumë kthim te dinamika e Brukselit pa një fund të qartë dhe përfshirje fillestare amerikane në këtë projektin ekonomik, që edhe ai mbetet deri më tani i paqartë. Nuk duhet harruar se vonesën tonë për të mos kuptuar drejt përkushtimin amerikan dhe të vetë presidentit Trump,



kundërthëniet në rritje në mes të ShBA-së dhe BE-së, do të shfrytëzohen nga Rusia për të destabilizuar rajonin dhe nga Kina për të depërtuar fillimisht ekonomikisht në rajon.

“Epoka e re”: Cili mund të jetë ndikimi i këtyre akuzave dhe të tjerave që mund të ngrehën në proceset nëpër të cilat po kalon Kosova?

Murati: Për mua ishte befasi, siç e theksova, momenti kohor dhe përmbajtja e deklaratës, por jo edhe ngritja e aktakuzave. Kosovës dëmi iu ka shkaktuar me raportin e Dik Martit të vitit 2010 dhe Rezolutën e Këshillit të Evropës, e bazuar në këtë raport dhe me mosaftësinë e institucioneve tona që në mënyrë adekuate ta trajtojnë këtë çështje. Por në anën tjetër duhet theksuar se ndjekja e krimeve të luftës në Kosovë ka qenë në duar të UNMIK-ut fillimisht, e më pas të EULEX-it. Në këtë kontekst Kosova ndoshta ka mund të bëjë më shumë që të përpikëj të krijonte në atë kohë një gjykatë

për ndjekjen e krimeve të luftës duke u bërë presion ndërkombëtarëve por, megjithatë, është e padrejtë të akuzohet për diçka që nuk ka qenë në përgjegjësitë e saj. Kështu, themelimi i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit Special nga ana e Kuvendit të Kosovës u bë nën presionin e madh të aleatëve tanë ndërkombëtarë dhe kërcënimit se, nëse Kosova nuk i themelon, atëherë ata nuk do ta pengojnë Rusinë që përmes KS të OKB-së t'i krijojë ato, me qëllim të ndjekjes së krimeve që kanë bërë shqiptarët, përkatësisht pjesëtarët e UÇK-së. Sidoqoftë, si atëherë e si sot mendoj se kjo është një ndër padrejtësitë më të mëdha në fushën e ndjekjeve të krimeve të luftës në ish-Jugosllavi, por edhe një padrejtësi e madhe politike ndaj Kosovës dhe një përpjekje për ta njoollur UÇK-në e luftën tonë në mënyrë që në një mënyrë ose tjetër të balancohen dhe merren parasysh edhe interesat dhe ndjenjat Serbisë e të Rusisë. Sigurisht çdo jetë njeriu është e

ERI E UNITETIT KOMBËTAR



vlefshme dhe duhet bërë përpjekje që çdo krim të zbardhet. Mirëpo në rastin tonë kjo kinse drejtësi ka marrë konotacion politik dhe trajton vetëm njëherë palë (UÇK-në), e me elemente të një gjykate që ndjek vetëm një etni, standard ky i paaplikuar ndonjëherë. Për më tepër, tani së fundmi ZPS e trajton veten edhe si organizatë politike me mision ri rregullimin e skenës politike në Kosovë e që kështu do të ndikojë në skenën politike të brendshme dhe atë ndërkombëtare që ka të bëjë me Kosovën. Kështu, Dhomat e Specializuara dhe ZPS shndërrohen nga mekanizma drejtësie në mekanizma padrejtësie. Sot, pas 20 vjetëve të përfundimit të luftës në Kosovë, ajo që do t'i shërbehet opinionit publik në Kosovë dhe në botë, do të jetë një fotografi e përmbysur e ngjarjeve në Kosovë, ku viktimat dhe çlirimtarët do të trajtohen në rolin e kriminelëve të luftës. Kjo duket e rëndë sidomos kur ka një ndjenjë të përgjithshme që ndjekja e krimeve të luftës

kundër shqiptarëve nuk ka qenë në nivelin e duhur qoftë nga Tribunali i Hagës, qoftë nga gjykatat serbe e, po ashtu, edhe nga ato të Kosovës të cilat më shumë kanë ndjekur shqiptarë për krime lufte sesa pjesëtarët e forcave të sigurisë së Serbisë. Përndryshe, jam krenar që deputetët e LB-së, qoftë në mandatin 2010-2014 (Aurora Bakalli dhe Agim Kuleta), qoftë në atë 2014-2017 (Raif Qela) kanë votuar kundër krijimit të kësaj gjykate. Në anën tjetër, ka një tendencë brenda Kosovës tani e një kohë të gjatë që këto mekanizma t'i shohin si shpëtim në luftën kundër korrupsionit dhe atë që ata e quajnë kapje të shtetit. Kjo është një qasje jo vetëm e padrejtë, por edhe e padenjë. Me këto procese do të dëmtohet Kosova dhe lufta jonë e drejtë e më së paku individët e caktuar. Dhe, së dyti, korrupsioni nuk mund të luftohet duke u arrestuar dhe dënuar individët për krime lufte. Ata ashtu do të bëhen heronj për së dyti. Korrupsioni luftohet vetëm duke krijuar shoqëria jonë një potencial të tillë demokratik që do të arrijë që këtë dukuri dhe dukuri të tjera të dëmshme t'i luftojë vetë. Përndryshe, kur ky potencial nuk ekziston, atëherë shumë lehtë një i korruptuar dhe një kapës shteti do të zëvendësohet me një tjetër. Në këtë rast vetëm emrat do të ndryshonin e ne do të mbesnim duke pritur te ndonjë gjykatë e ardhshme ndërkombëtare që kushedi se për çka do të krijohej për ne për t'i eliminuar të tillët. Nuk bëhet dhe nuk mbahet shtëpia me shpresën e tjetrit.

"Epoka e re": Qeveria është deklaruar pro vazhdimin të dialogut me Serbinë. Pas këtyre rrethanave, cila duhet të jetë qasja e Kosovës në këtë proces?

Murati: Unë mendoj se për zgjidhjen e problemeve në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk ka alternativë tjetër veç dialogut. Çështja nuk është te dialogu si mjet për zgjidhjen e problemeve në mes të dy shteteve, por te përmbajtja e dialogut e, mbi të gjitha, te qasja e palës së Kosovës. Deri më tani ne kemi një qasje të pandryshuar nga të gjitha qeveritë tona: e kemi ditur se çka nuk duan dhe zakonisht këto janë përcjellë me një fontanë dëshirash, të cilat

kryesisht në fund kanë përfunduar me dëshirën/objektivin për njohjen e dyanshme. Pak a shumë kjo ishte edhe qasja e kryeministrit Hoti në samitin virtual të Parisit. Dhe pasoi menjëherë një reagim i palës serbe, se do të refuzohet një qasje e tillë. Në thelb dialogu është shumë më kompleks, me plot vështirësi e rreziqe dhe duhet shpjeguar qartë opinionit se nga ai do të dilet edhe me kompromise. Nuk e kemi kuptuar se po bëhet fjalë për përpjekjen për ta përmbyllur kapitullin e një konflikti mbi 100 vjeçar në mes të Serbisë dhe shqiptarëve, e që i ka rënë barrështetit të Kosovës ta përmbyllë në emër të krejt shqiptarëve. Betejën kryesore forcat tona politike dhe qeveritë e vendit e kanë pasur me presidentin Thaçi pasi ai doli me idenë e korrigjimit të kufirit në vend se të ulen dhe trajtojnë të tërat shumë seriozisht si anët e mira të saj, si anët e këqija e, po ashtu, edhe rreziqet e kurthet e mundshme. Sado që presidenti, sipas mendimit tim, nuk e ka shpërfaqur këtë ide në mënyrën e duhur lufta që i është bërë idesë, ka qenë joparimore dhe e drejtuar kryesisht më shumë kundër figurës së presidentit. Sidoqoftë, tani të gjithë po trumbetojnë se ideja e korrigjimit të kufirit apo shkëmbimit të territoreve, apo sido që i kanë thënë, ka vdekur. Mirë! Bravo! Por a po na tregojnë ata se cilën ide e përfaqësojnë dhe çfarë projektesh të tjera mund të vijnë në tavolinë? Publikisht janë ato që i quajta si fontanë dëshirash. Por të gjithë e përmendin jo-formalisht apo me gjysmë zëri edhe publikisht idenë e asociacionit plus apo një autonomie politike territoriale për serbët në Kosovë. Të tilla projekte do të ishin fatale për funksionimin normal të shtetit të Kosovës qoftë edhe nëse bëhemi anëtarë të OKB-së dhe nëse na pranon Serbia. Por edhe mbetja në këtë situatë status-quoje, pra me këtë kushtetutë aktuale përmes së cilës serbët kanë të drejtë vetoje në ndryshimet kushtetuese dhe në shumë ligje vitale për Kosovën, nuk i përshtatet Kosovës. Të gjitha këto opsione e lënë Serbinë me ndikim në Kosovë, për të mos thënë e lënë Serbinë brenda Kosovës qoftë

përmes Listës Serbe, qoftë përmes mekanizmave kushtetues e juridikë që ia mundësojnë këtë. Andaj unë i shoh vështirë të implementueshme këto projekte edhe nëse arrihet marrëveshja për to. E vetmja mënyrë për ta larguar tërësisht Serbinë nga Kosova është projekti i ripërcaktimit të kufijve, të cilën Lëvizja për Bashkim e ka shndërruar në platformë politike që në vitin 2010. Sipas nesh, pjesët shqiptare të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës duhet t'i bashkohen Kosovës dhe pjesët serbe të Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut duhet t'i bashkëngjiten Serbisë. Kjo marrëveshje do të mundësonte edhe ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës dhe heqjen e privilegjeve kushtetuese për serbët e Kosovës (por normalisht jo edhe të drejtat e tyre) e rrjedhimisht do të krijoheshin rrethanat që Kosova jo vetëm të anëtarësohej në organizatat ndërkombëtare, por edhe ta shtrinte sovranitetin në tërë territorin e vet e të krijonte kushte reale për agjenda të tjera politike si sundimi i ligjit dhe zhvillimi ekonomik. Vetëm në një rrethanë të tillë krijohen mundësitë edhe për një bashkim potencial me Shqipërinë nëse për këtë do të kishte vullnet politik. Unë sigurisht nuk kam dyshime se ky vullnet do të ishte pro bashkimit (ndërsa forma e bashkimit si union, federatë, konfederatë, apo bashkim klasik do të mbetej çështje e marrëveshjes) sepse vetëm si të bashkuar Kosova e Shqipëria do të kishin potencial që të siguronin të ardhmen e tyre si në planin politik, atë ekonomik e të sigurisë në një botë që po ndryshon në mënyrë shumë dinamike, sidomos me forcimin e Rusisë dhe Kinës. Kështu, sado që është shpallur i vdekur projekti i ripërcaktimit të kufijve, unë jam i bindur se ky do të jetë projekti që në fund do t'i zgjidhë problemet në mes të dy vendeve dhe popujve. Një hall e kam se, nëse vonohemi shumë, mund ta humbasim krejtësisht Kosovën Lindore në njëherë anë, në tjetrën Serbia ta bëjë realitet vendosjen e kufirit te lumi Ibër.

"Epoka e re": Derisa Kosova pritet të përballet me proceset

shumë të rëndësishme, qeveria aktuale duket e brishtë në numra. Që tri herë po dështon ratifikimi i disa marrëveshjeve ndërkombëtare. Mund të vazhdojë kjo qeveri, apo mund të presim ndonjë qeveri me bazë më të gjerë?

Murati: Qeveria vërtet është e brishtë dhe e ka marrë detyrën në një moment të rëndë dhe të brendshëm dhe të jashtëm. Kriza politike e brendshme, e përcjellë me pandeminë në rritje këto ditë në njëherë anë dhe krizën ekonomike në anën tjetër po ashtu si pasojë e pandemisë, po ia bënë të vështirë jetën kësaj qeverie. Por në anën tjetër është papërgjegjësi e madhe njerëzore, politike, shtetërore e kombëtare mosvotimi i marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i sigurojnë Kosovës projekte milionëshe dhe të dedikuara edhe për luftën kundër pandemisë dhe pasojave ekonomike që ajo ka shkaktuar. Kjo sjellje e papërgjegjshme dëshmon se kjo klasë politike është tërësisht e pandjeshme për interesat publike dhe më shumë sesa për interesat e Kosovës brengoset se si hapat e këtyre politikë do të shpërblehen në vota. Kjo është brengosëse. Në anën tjetër duket se ka gjasa që kjo qeveri ka vullnet për t'u zgjeruar edhe me PDK-në, sidomos pas krizës së fundit rreth ngritjes së aktakuzës për presidentin dhe z. Veselin. Sidoqoftë, cili do të jetë qëndrimi i PDK-së mbetet për t'u parë. Nuk duhet harruar se në lojë do të jetë edhe pozicioni i presidentit vitin e ardhshëm, apo pas ndonjë dorëheqjeje të mundshme të z. Thaçi e për të cilin nëse nuk ka një konsensus më të gjerë, vendi duhet të shkojë në zgjedhje të reja. Unë vazhdoj të besoj se zgjidhja më e mirë do të ishte të kishim një qeveri të unitetit kombëtar e cila do ta udhëhiqte vendin deri në përfundimin e dialogut me Serbinë dhe realizimin e një reforme zgjedhore dhe atëherë do të kishte kuptim edhe të kishim zgjedhje të reja parlamentare. Mos të harrojmë se qeveritë e fundit janë rrezuar për shkak të dialogut. I tillë do të jetë edhe fati i kësaj qeverie nëse nuk krijohet një bashkërendim më i madh në mes të forcave politike për dialogun.

Gjykata Speciale, përcaktuese e bisedimeve midis Serbisë dhe Kosovës

Nga: KMDLNj

Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë, pasi e mbajti dy muaj të fshehur propozimaktakuzën ndaj presidentit Hashim Thaçi, ish-kryetarit të Kuvendit dhe kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli dhe nëntë të tjerëve që nuk kanë emër dhe mbiemër e që nënkupton se trajtohen vetëm si numra. Bërja publike e këtij pamfleti politiko-juridik në një kohë të paparë për vazhdim të bisedimeve për një marrëveshje përfundimtare me Serbinë, sikur edhe përpjekja për përjashtim nga këto bisedime të presidentit Thaçi dhe kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli, është ndërhyrje e drejtpërdrejtë e Gjykatës Speciale në procesin e bisedimeve, me qëllim të qartë të ndikojë edhe në përmbajtjen e marrëveshjes përfundimtare duke e dobësuar fort pozitën negociuese të Kosovës dhe duke e rehabilituar Serbinë për të gjitha krimet dhe vetë njërin nga kriminelët e luftës, Aleksandar Vuçiqin.

Nuk është aspak e vështirë të parashikohet rezultati final i bisedimeve kur ata që ishin më meritorët për çlirim dhe lirinë e Kosovës pamundësohen të jenë pjesë e marrjes së vendimeve për të ardhmen e

Kosovës, kurse një kriminel luftë si puna e Aleksandar Vuçiqit i bëhen aq shumë favore në vend se të thirret në përgjegjësi për krimet e luftës të kryera në Bosnje, Kroaci dhe Kosovë, si shef për Agjitacion dhe Propagandë të kryekriminelit, Slobodan Millisheviq. Bërja publike e një propozimaktakuzë, pa u konfirmuar nga gjykatësi i procedurës paraprake, në një kohë të ndjeshme të një procesi gjithashtu të ndjeshëm nga të gjithë njohësit e proceseve dhe rrethanave, u konsiderua si presedan i rrezikshëm, veprim paragykses me qëllim të qartë të ndërhyrjes në rezultatet finale të një procesi politik. Sidomos këtë e thanë ndërkombëtarët që edhe vetë ishin më parë, pjesë e bisedimeve. Është e habitshme pse për këtë dhunim flagrant të procedurës nga Zyra e Prokurorit të Specializuar nuk reagon fare i ashtuquajturit Ombudsperson i kësaj Gjykate apo edhe Gjykata Kushtetuese e cila edhe ex officio do të duhej t'i mbronte të drejtat e njeriut që keqtrajtohen nga Gjykata Speciale.

Në rastin konkret, të drejtat e njeriut të Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit, përmes një linçimi publik që ua ka bërë Zyra e Prokurorit të Specializuar, janë



shkelur në kundërshtim me të gjitha të drejtat që janë rregulluar dhe mbrohen me dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Me ndarje selektive të drejtësisë dhe me përjashtim arbitrar nga kjo e drejtë, të motivuar politikisht, të pjesës dërrmuese të viktimave, Gjykata Speciale e shkelë dhe e dhunon plotësisht parimin e universalitetit të të drejtave të njeriut të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara.

Pas këtij linçimi publik të motivuar politikisht e që nuk ka ndodhur në asnjë rast më parë është iluzore të pritët se në një proces të mundshëm gjyqësor ndaj tyre do të ketë gjykim fer, të drejtë, të paanshëm dhe të pandikuar politikisht. Krimet e

luftës dhe krimet kundër njerëzimit nuk vjetrohen dhe nuk falen derisa nuk ndryshon legjislacioni i së drejtës ndërkombëtare që rregullon këtë çështje. Gjykimet dhe dënimet për krime luftime nuk mund të përdoren për baraspeshim të përgjegjësisë, për arritje të qëllimeve të caktuara të politikave ditore apo strategjike, imponimit të paqes apo pajtimit midis palëve ndërluftuese.

Këto gjykime, nëse janë të drejta e që sigurojnë drejtësi për të gjitha viktimat, pa bërë asnjë dallim sikur që e cakton përgjegjësinë në përputhje me peshën e krimeve, pas provave të administruara, gjithashtu pa bërë asnjë dallim në baza etnike e ndihmon ndërtimin dhe qëndrueshmërinë e paqes e që është edhe kushti kryesor për

pajtim midis palëve që luftuan. Gjykata Speciale nuk e ka këtë qëllim për faktin se ka qasje diskriminuese dhe përjashtuese ndaj viktimave, sipas përkatësisë etnike dhe në këtë mënyrë i trajton edhe ata që kanë përgjegjësi për krime luftime. Askush nuk ka të drejtë ta pengojë drejtësinë për viktimat sikur edhe përgjegjësinë për ata që kanë bërë krime mirëpo, askush nuk ka, gjithashtu të drejtë, të ndajë drejtësi dhe përgjegjësi sipas parimit etnik.

Gjykata Speciale duhet t'i trajtojë të gjitha rastet e krimeve të luftës në Kosovë e që nuk janë trajtuar nga gjykatat paraprake, në të kundërtën çdo vendim i saj do të konsiderohet i dyshimtë dhe vendim i një gjykate të instrumentalizuar nga politika. Gjithmonë aty ku politika ka përpiluar aktakuzat dhe ku gjykatat kanë formalizuar kryesisht teknikisht një vendim të tillë, problemi është konservuar për një kohë për të shpërthyer shumë më dhunshëm pastaj. Kosova ka nevojë imediate për drejtësi për të gjitha viktimat si dhe dënimin e të gjithëve që iu dëshmohej se kanë bërë krime, pa bërë dallime, në asnjë bazë. Deri më tani Gjykata Speciale nuk e ka dëshmuar se është e gatshme ta bëjë këtë.

Nisma Socialdemokrate: Të gjitha përpjekjet dashakeqe kundër nesh do të dështojnë

PRISHTINË, 10 KORRIK (ER) - Nisma Socialdemokrate përmes një komunikate për media ka theksuar se si subjekt politik janë ballafaquar me përpjekjet e vazhdueshme që të minohet krijimi i kësaj force të re politike. "Këto përpjekje dashakeqe morën përmasa shumë më të mëdha gjatë zgjedhjeve parlamentare në vitin 2014. Gjatë kohës kur të gjithë dalin në fushatë për ta bindur elektoratin për programet e tyre, një fushatë e paparë deri atëherë filloi kundër nesh, me qëllim që ta pamundësonin përfaqësimin e votuesve të Nismës Socialdemokrate në Kuvendin e Kosovës. Anëtarët dhe simpatizantët e partisë sonë e përjetuan shumë rëndë këtë fushatë shpifjesh, intrigash dhe joshjesh që përdorshin kundër nesh, sepse vinte kryesisht nga njerëz me të cilët kemi pasur një të kaluar të përbashkët. Sidoqoftë, askush nuk mundi ta ndalë vullnetin e dhjetëra mijëra votuesve që u mobilizuan për të ngadhënjyer mbi intrigantët dhe shpifësit: Nisma Socialdemokrate atëherë (Nisma për Kosovën) u bë pjesë e Kuvendit të Kosovës!",



thuhet në komunikatën e Nismës Socialdemokrate.

Më tej në këtë komunikatë thuhet se "duke e vënë në rend të parë interesin shtetëror, Nisma Socialdemokrate i tejkaloi të gjitha ndërkëmbësarët që na i vunë gjatë rrugëtimit tonë dhe zbatoi politikën e harmonizimit të qëndrimeve në interes të Kosovës. Fatkeqësisht, nga partnerët politikë të cilëve u ofruam mbështetje dhe ata që e kanë gojën plot premtime se 'janë njerëz që e mbajnë fjalën', për asnjë çast nuk i ndërprejnë

veprimet e tyre kundër nesh! Përkundrazi, në të gjitha rastet që u është dhënë mundësia, ata janë përpjekur ta dëmtojnë Nismën Socialdemokrate. Përpjekjeve për shkatërrimin e zërit të votuesve të Nismës Socialdemokrate iu shtuan edhe forca të reja politike, sidomos gjatë zgjedhjeve të fundit parlamentare. Përkundër të gjitha metodave që u përdorën për të na lënë jashtë Kuvendit të Kosovës, ngadhënjëu vullneti i pathyeshëm i anëtarëve dhe i simpatizantëve të Nismës", theksohet në komunikatën e

Nismës Socialdemokrate.

Ky subjekt politik ka theksuar se duke parë kontekstin historik nëpër të cilin kalon vendi ynë dhe rreziqet me të cilat ballafaqohet Kosova, Nisma Socialdemokrate doli me qëndrim për harmonizimin e qëndrimeve dhe bashkërenditjen e veprimeve në funksion të përballjes me padrejtësitë ndaj luftës së drejtë të UÇK-së. "Dhe pikërisht në këto momente të vështira për shtetin tonë, kur na duhet uniteti, ata që rrahin gjoks se 'janë njerëz të fjalës', vazhduan me joshje të

anëtarëve tanë dhe forma të tjera të presionit, vetëm që ta dëmtojnë Nismën Socialdemokrate! E dimë se në të gjitha partitë politike ka njerëz laknitarë që interesat e veta i vënë jo vetëm mbi partinë, por edhe mbi interesat e kombit dhe ato të shtetit. Dhe të tillët e tregojnë fytyrën e vërtetë në momentet më kritike. Sidoqoftë, ne nuk do ta ndryshojmë orientimin tonë politik për t'i vënë në rend të parë interesat e vendit dhe kemi bindjen e plotë që kjo gjë mund të realizohet edhe më mirë pa ata që vënë interesin e tyre personal në rend të parë. Jemi të sigurt se të gjitha përpjekjet dashakeqe kundër nesh do të dështojnë sepse vullneti i anëtarëve, i simpatizantëve dhe i strukturave udhëheqëse të Nismës Socialdemokrate është shumë më i madh se lakmitë dhe intrigat e dikujt tjetër", është thënë në komunikatën e Nismës Socialdemokrate.

Para disa ditësh deputeti Haxhi Shala është larguar nga Nisma Socialdemokrate për t'u bërë pjesë e AAK-së. Për shkak të largimit të tij janë larguar edhe disa individë të tjerë nëpër degë të ndryshme të Nismës.

Gjermania i dhuron Kosovës 6 000 teste për Covid-19

Ministria e Shëndetësisë e Gjermanisë i ka dhuruar Kosovës 6 000 teste për Covid-19. Në një konferencë të përbashkët për media me ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj, i cili ka marrë pjesë në ceremoninë e dhurimit të këtyre testeve, ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, u ka bërë thirrje qytetarëve që t'i respektojnë masat e nevojshme të sigurisë dhe institucionet përgjegjëse t'i zbatojnë politikën e kërkuara në mënyrë që ta parandalojnë përhapjen e mëtejshme të virusit në Kosovë



**EPOKA
ERE** Fatobn DËRMAKU

PRISHTINË, 10 KORRIK - Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, i ka dorëzuar të premtën 6 000 teste për Covid-19 Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, të cilat janë siguruar dhe financuar nga Ministria e Shëndetësisë e Gjermanisë. Në një konferencë të përbashkët për media me ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj, i cili ka marrë pjesë në ceremoninë e dhurimit të këtyre testeve, ambasadori Heldt u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve që t'i respektojnë masat e nevojshme të sigurisë

dhe institucionet përgjegjëse t'i zbatojnë politikën e kërkuara në mënyrë që të parandalojnë një përhapje të mëtejshme të virusit në Kosovë. "Janë 6 000 teste që mendoj se do t'ju dalin në ndihmë në këtë fazë", ka thënë ambasadori gjerman.

Heldt ka thënë se secili duhet t'i respektojë rregullat që janë vendosur nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës. "Maska nuk është shenjë e dobësisë, por shenjë e respektimit të personit pranë jush", është shprehur ambasadori Heldt.

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka falënderuar shtetin gjerman për këtë kontribut të drejtpërdrejtë në

luftën kundër Covid-19.

Ministri Zemaj ka thënë se numri në rritje i rasteve me Covid-19 tregon për nevojën që të respektohen masat e ndërmarra. "Numri i rasteve ka shkuar në rritje, por me këto ndihma do t'ia dalim ta kemi një gjendje normale edhe të furnizimit me teste dhe pjesët e tjera të nevojshme", ka thënë ai. Zemaj ka theksuar se sistemi

shëndetësor është ngarkuar dhe për këtë arsye duhen ruajtur profesionistët shëndetësorë, sikurse edhe popullata, derisa ka shtuar se furnizimi është stabil, por se duhet bërë kujdes.

Në kuptim të rritjes së kapaciteteve spitalore, ministri Zemaj ka pohuar se ekziston një pajtueshmëri me Forcën e Sigurisë së Kosovës që, nëse ka

nevojë, mund të përdoret edhe shërbimi shëndetësor i kësaj force për trajtimin e pacientëve me koronavirus.

Testet të cilat janë dhuruar nga Ministria e Shëndetësisë e Gjermanisë për Kosovën janë prodhuar nga kompania gjermane "Thermo Fischer" dhe i plotësojnë të gjitha kërkesat e laboratorëve kompetentë në Kosovë.

Selimi: Dizajnimi i sistemit të llogaridhënies, përfshirë vettingun, duhet të jetë i implementueshëm

**EPOKA
ERE** F. DËRMAKU

PRISHTINË, 10 KORRIK - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, të premtën ka mbajtur një konferencë për media, në të cilën ka folur për procesin e dizajnit të sistemit të llogaridhënies duke përfshirë edhe vettingun. Ai ka thënë se lidhur me procesin e vettingut kanë vendosur që të krijojnë një proces konsultativ me të gjithë hisedarët e drejtësisë, përfshirë edhe grupin sipas vendimit nr. 0804 të datës 28.02.20 nga qeveria e kaluar. "Gjatë kësaj kohe, së bashku me zëvendëskryeministrin Driton Selmanaj, kemi konsultuar Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Gjykatën Supreme, Prokurorinë e Shtetit, Gjykatën Themelore dhe, po ashtu, kemi konsultuar partnerët tanë strategjikë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, BE-në, Mbretërinë

e Bashkuar, Gjermaninë, Italinë, misionin e OSBE-së si dhe shoqërinë civile. Pas diskutimeve, kemi arritur në përfundim që të gjithë janë për që të jenë pjesë e një dizajni të sistemit të llogaridhënies, përfshirë edhe vettingun. Po ashtu, jemi pajtuar se ky proces të jetë gjithëpërfshirës dhe jemi pajtuar që ta gjejmë mënyrën më të mirë se si ta zhvillojmë procesin e dizajnit të sistemit të llogaridhënies duke përfshirë edhe vettingun", ka thënë Selimi, duke shtuar se nga takimi që kanë mbajtur me grupin e ekspertëve të caktuar në vendimin 0804, kanë diskutuar gjerë e gjatë dhe janë pajtuar që pas një kohe si Ministri e Drejtësisë t'i dërgojnë termat e referencës dhe vizionin e kësaj ministrie për gjithëpërfshirje, përfaqësim dhe vizionin për inkluzivitet. "Pasi që kemi dërguar propozimin për përfaqësuesit nga institucionet dhe termat e referencës të cilat i



përbajnë elementet kyçe të termave të referencës të komisionit të kaluar, përmes një deklarate publike ky grup i ekspertëve ka dhënë dorëheqje duke i cekur disa prej arsyeve se përse nuk dëshirojnë të jenë

pjesë e këtij procesi. Për të qenë korrekt dhe për ta respektuar parimin mbi të cilin ne edhe kemi filluar që ta mbledhim grupin gjithëpërfshirës, në vendimin i cili do t'i propozohet sot Qeverisë për aprovim, ne

ende do ta mbajmë të hapur pikën ku grupi i ekspertëve është i mirëseardhur të marrë pjesë në këtë proces të dizajnit të sistemit të llogaridhënies, duke përfshirë edhe vettingun", ka thënë ministri Selimi.

Ministrja Bajrami shpalos planet për përkrahjen e sektorit privat pas pandemisë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 KORRIK - Ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka marrë pjesë në një forum virtual me biznese të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, gjatë të cilit është diskutuar mbështetja për sektorin privat dhe bizneset të cilat janë goditur më së shumti nga pandemia Covid-19, e cila ka shkaktuar ndërprerjen e paprecedentë të aktiviteteve ekonomike e, rrjedhimisht, ka stagnuar edhe zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës.

Ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka thënë se Ministria e Financave po pret aprovimin e buxhetit të rishikuar nga ana e Kuvendit që të mund t'i ekzekutojë mjetet e parapara në pakon emergjente fiskale si dhe në Pakon e Rimëkëmbjes.

Ministrja Bajrami ka sqaruar se Pakoja e Rimëkëmbjes përfshin edhe lehtësimin në qasjen e bizneseve në financa përkatësisht. "Te Pakoja për Rimëkëmbje Ekonomike jemi

fokusuar shumë te qasja në financa dhe instrumente të tilla prej të cilave bizneset mund të përfitojnë bazuar në parimet dhe kriteret e njëjta, por edhe ky përfitim mund të jetë shumë afatgjatë. Jemi duke punuar me Fondin për Garanci Kreditorë që të hapen disa dritare për disa sektorë. Ne kemi marrë përgjegjësinë që gjatë këtij viti dhe në vitin tjetër ta rrisim kapitalin e Fondit për Garanci Kreditorë deri në 100 milionë euro dhe mbulueshmëria e rrezikut për këto kredi të jetë deri në 80 për qind. Gjithashtu, si qeveri gjatë kohës së pandemisë ne do ta bartim komplet tarifën të cilën e ngarkon Fondi për Garanci Kreditorë", ka thënë ministrja Bajrami, ndërsa ka shtuar se me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, qytetarët do ta kenë mundësinë që në mënyrë vullnetare të tërheqin 10 për qind nga mjetet e tyre të kursyera në Fondin Pensionsal.

Ministrja Bajrami ka pohuar se sektori i teknologjisë së informacionit do ta ketë vëmendjen e Qeverisë për shkak



të mundësive të shumta që ofron ky sektor për punësimin e rinisë së Kosovës, duke theksuar se Ministria që ajo drejton dhe Qeveria e Kosovës në përgjithësi janë të interesuara për iniciativat që mund të ofrojë shteti për fuqizimin e sektorit të teknologjisë dhe digjitalizimit përmes investimeve dhe trajnimeve.

Ministrja sqaroi më tej se është krijuar një grup punues për përpilimin e udhëzimit administrativ për pushimet

tatimore për investimet e reja, ndërsa në të njëjtën kohë në ditët në vijim do të përpilohet edhe kalendari i akcizës, i cili do të rriste parashikueshmërinë në mesin e bizneseve që u nënshtrohen detyrimeve të akcizës, ndërsa me qëllim të përkrahjes së sektorit të gastronomisë, po rishikohet propozimi i komunitetit të biznesit për ulje të tatimit mbi vlerën e shtuar nga 18 për qind, në 8 për qind.

Përfaqësuesit e bizneseve, anëtarë të Odës Amerikane, ishin pjesë aktive e këtij forumi dhe dhanë

rekomandimet e tyre mbi përkrahjen e kësaj ministrie dhe shtetit në përgjithësi dhe mënyrave më efektive se si mund të ndihmohet sektori privat, por edhe ekonomia e Kosovës për dalje nga kriza e shkaktuar nga pandemia. Disa nga çështjet e ngritura nga përfaqësuesit e sektorit privat ishin tkurja e buxhetit dhe investimeve kapitale, zbritja e numrit të punëtorëve nëpër ndërmarrje dhe bashkëpunimi mes organeve të qeverisë dhe sektorit privat në Kosovë.

Klubi i Prodhuesve: Procesi i rimëkëmbjes ekonomike të fokusohet në përkrahjen e prodhimit



PRISHTINË, 10 KORRIK (ER) - Bordi i Klubit të Prodhuesve të Kosovës është takuar të premten me ministren e Financave, Hykmete Bajrami, me të cilën ka diskutuar për zhvillimet e përgjithshme në ekonominë e vendit si dhe për vështirësitë e sektorit të prodhimit në Kosovë për shkak të pandemisë Covid-19, gjithashtu edhe për planet e qeverisë për rimëkëmbjen ekonomike. "Në takim palët shkëmbyen pikëpamjet e tyre sa i përket situatës ekonomike dhe u zotuan

ta vazhdojnë dialogun për tema që kontribuojnë në përmirësimin e kushteve të sektorit të prodhimit dhe rritjes ekonomike të vendit. Gjatë takimit u diskutua rreth kërkesave të cilat u paraqiten nga prodhuesit, por edhe rreth planit të mbështetjes së prodhuesve nga pasojat e pandemisë. Kërkesë kryesore e prodhuesve ishte që procesi i rimëkëmbjes ekonomike të fokusohet përmes përkrahjes së prodhimit. Largimi i pagesës së TVSh-së për lëndën e parë që

prodhohet në Kosovë, rregullimi i sistemit të pagesave ku do të tejkalohen vonesat e shumta, si dhe mbështetja e fushatës Made in Kosova, e cila ka për qëllim kryesor fuqizimin e prodhimeve vendore", është bërë me dije në njoftimin e Klubit të Prodhuesve të Kosovës.

Bordi i Klubit të Prodhuesve ka falënderuar ministren Bajrami për takimin dhe ka shprehur gatishmërinë që bashkëpunimi me Ministrinë e Financave dhe institucionet financiare të thellohet edhe më tej.

KDI-ja: Qeveria duhet t'i bashkërendojë qëndrimet me opozitën për rishikimin e buxhetit

PRISHTINË, 10 KORRIK (ER) - "Qeveria e Kosovës ka kërkuar nga Kuvendi rishikimin e buxhetit me procedura të përshtetshme për t'i sanuar pasojat ekonomike dhe shëndetësore që ka shkaktuar pandemia. Ky projektligj do të jetë në shqyrtim të parë në vazhdimin e seancës së sotme. Sidoqoftë, për trajtimin e projektligjit me procedura të përshtetshme, kërkohet shmangie nga Rregullorja me votat e 2/3 të deputetëve të

pranishëm, që nënkupton se nevojitet pajtueshmëri më e gjerë mes grupeve parlamentare në pozitë dhe atyre në opozitë", është thënë në komunikatën e KDI-së.

KDI-ja ka theksuar se duke pasur parasysh situatën e ndjeshme me pandeminë është e domosdoshme që buxheti i rishikuar të jetë reflektim i qëndrimeve të të gjitha partive politike. "Andaj, KDI kërkon nga koalicioni qeverisës t'i shtojë përpjekjet për gjetjen e një gjuhe

të përbashkët me opozitën, duke marrë parasysh propozimet dhe kërkesat e tyre në funksion të arritjes së pajtueshmërisë për kalimin e projektligjit për rishikimin e buxhetit. KDI konsideron se një qasje bashkëpunuese mes qeverisë dhe opozitës, e promovuar dhe e kultivuar nga qeveria, duhet të mbizotërojë në angazhimin e përbashkët për përballje me pandeminë dhe pasojat e saj", është thënë në komunikatën e KDI-së.



Piraj: Nga tani është hapur një portë e madhe për prodhimet e mishit dhe qumështit nga Kosova drejt BE-së

Burim Piraj nga kompania vendore "Meka" ka thënë për gazetën "Epoka e re" se lajmi për vendimin e Bashkimit Evropian për përfshirjen e Kosovës në listën e vendeve të treta me të drejtë eksporti për produktet ushqimore me origjinë shtazore në vendet e BE-së është lajm që prej vitesh e prisnin. Sipas tij, nga tani është hapur një portë e madhe për prodhimet e mishit dhe të qumështit nga Kosova drejt BE-së

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 10 KORRIK - Në gazetën zyrtare të Bashkimit Evropian L 220/5 është publikuar vendimi për përfshirjen e Kosovës në listën e vendeve të treta me të drejtë eksporti për produktet ushqimore me origjinë shtazore në vendet e Bashkimit Evropian.

Në këtë listë Kosova për herë të parë e fiton këtë të drejtë. Lidhur me këtë, Burim Piraj nga kompania vendore "Meka" ka thënë për gazetën "Epoka e re" se këtë lajm prej vitesh e prisnin. Sipas tij, nga tani është hapur një portë e madhe për prodhimet e mishit dhe të qumështit nga Kosova drejt BE-së. "Këtë lajm ka dekada që e presim. Nga tani

është hapur një portë e madhe për prodhimet e mishit dhe të qumështit nga Kosova drejt BE-së. Ka qenë e ditur se ka edhe procedura të tjera derisa të fillojë eksporti, mirëpo tanimë problemi nuk është politik e as nuk është institucional, por është procedural si në çdo vend tjetër", ka thënë Piraj.

I pyetur se sa është sasia e

prodhimit të produkteve të "Mekës" "Hallall" dhe a mendon se Kosova do të ketë kapacitete për të eksportuar", Piraj është përgjigjur: "Ne kemi kapacitete të bollshme dhe kemi pajisje superiore për prodhim. Deri më tani kemi punuar në një ndërrim, tani kemi krijuar kushte shumë të mira për punë në tri ndërrime. Kështu që, do të jemi në gjendje të prodhojmë produkte të mjaftuara për Kosovë, por do të ofrojmë edhe për eksport. Në këtë drejtim po flas për produkte shumë cilësore, që janë plotësisht të prodhuara 100 për qind 'hallall', duke filluar nga mënyra e ushqimit të bagëtive dhe shpezëve deri te therja,

përpunimi dhe pakëtimi, e gjithë kjo në përputhje të plotë me ISO standard dhe me standardin 'Halal'", ka thënë ai.

Piraj ka folur edhe për përfitimet e këtij vendimi. "Përfitimi numër një dhe më i miri është se kjo do ta iniciojë hapjen e vendeve të lira të punës, pastaj do të iniciojë edhe zhvillimin e blegtorisë dhe të zinxhirit agro-industrial që lidhet me majmërinë dhe përpunimin e mishit. Nga kërkesat e deritanishme mendojmë se do ta rrisim shumë eksportin. Vendet ku do të eksportojmë do të jenë vendet ku ka më shumë bashkatdhetarë, si në Zvicër dhe Gjermani", është shprehur Piraj.



Zeka: 45 për qind e bizneseve në Kosovë kanë ndërprerë aktivitetin



PRISHTINË, 10 KORRIK - Ndonëse nuk ka pajtim për ndikimin e pandemisë në ekonominë e Kosovës, kryetari i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka thënë se 45 për qind e bizneseve kanë ndërprerë aktivitetin ose janë ndikuar drejtpërdrejt nga masat kufizuese të qeverisë. Ai është bazuar në një anketë që kanë kryer pesë organizata të biznesit.

Zeka ka deklaruar se humbjet ditore janë deri në dhjetë milionë euro në ditë për shkak të ndikimit të pandemisë. "Kjo është pjesa tjetër e fatkeqësisë. Ne kemi një shtet, kemi institucione publike, organizata si odat ekonomike, që përfaqësojnë interesat e sektorit privat, që nuk janë në gjendje të pajtohen për një set informatash për sa i përket ndikimit të pandemisë në sektorin privat apo në

ekonomi në përgjithësi", ka thënë Zeka në emisionin "Desku" në KTV.

Organizata që ai drejton ka zgjedhur rrugën institucionale, ka përcjellë të dhënat që janë paraqitur nga guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës. Sipas Zekës, guvernatori ka folur për humbje prej nëntë deri në dhjetë milionë eurosh. Behet fjalë për humbje ditore në ekonominë e Kosovës.

Deputetët zgjedhin kryeshefin dhe tre anëtarë të KOSTT-it

PRISHTINË, 10 KORRIK - Kuvendi i Kosovës ka zgjedhur kryeshefin e KOSTT-it dhe tre anëtarët e këtij bordi me mandat katërvjeçar. Deputetët përmes

votës, pozitën e kryeshefit ia besuan Jeton Mehmetit, ndërkaq anëtarë të bordit u zgjodhën Nebih Zariqi dhe Arben Dodaj. Për shkak të

garantimit të barazisë gjinore për bordin e KOSTT-it, në këtë konkurs u votua në dy kuti të ndara, por kandidatet gra nuk arritën t'i marrin votat e

nevojshme. Përkitazi me këtë u kërkua një mendim i komisionit përkatës se a duhet të rikthehet konkursi në pikën zero apo të ripërsëritet votimi.



Mbyllen dy furra të bukës në Malishevë, pasi pronari doli pozitiv me Covid-19

MALISHEVË, 10 KORRIK (ER) - Inspektorati Komunal në Malishevë, në kuadër të zbatimit të masave mbrojtëse kundër përhapjes së pandemisë Covid-19, të premtën i

ka mbyllur dy furra të bukës në qytetin e Malishevës, pasi pronari i tyre ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Pronari i furrave, i cili nuk është banor i Komunës së

Malishevës, e ka njoftuar Inspektoratin Komunal në Malishevë se ka rezultuar pozitiv në testin për Covid-19 dhe më pas inspektorati i ka ndërmarrë veprimet ligjore,

duke i mbyllur këto dy furra. Furrat do të mbesin të mbyllura deri në një vendim tjetër të organeve përgjegjëse, pasi i njëjti të konsiderohet plotësisht i shëruar.



Mbahet dëgjimi publik me banorët e katër fshatrave për përgatitjen e buxhetit të Komunës së Rahovecit

RAHOVEC, 10 KORRIK (ER) - Nën organizim të anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) të Kuvendit Komunal të Rahovecit, është mbajtur dëgjimi publik për përgatitjen e buxhetit të komunës për vitin 2021 me banorët e fshatrave Fortesë, Sapniq, Pataqan i Ulët dhe Xërxë.

Afrim Dina, kryesues i KPF-së, i ka falënderuar banorët e pranishëm në këtë dëgjim publik, duke thënë se buxheti i komunës për vitin 2021 është 4 milionë e 500 mijë euro dhe se kërkesat që do t'i marrin nga banorët do të inkorporohen në buxhetin e vitit 2021.

Besnik Popaj, kryetar i këshillit të fshatit Fortesë, i ka paraqitur kërkesat e fshatit të tij. "Përfundimi i ndërtimit të objektit të shkollës fillore, rreg-

ullimi i ndriçimit publik, rregullimi i rrugëve fushore, kubëzimi i rrugëve, rregullimi i kanalizimeve, rregullimi i shtratit të lumit 'Belleja' deri në dalje te Drini i Bardhë, rregullimi i varrezave dhe rregullimi i terreneve sportive", kanë qenë kërkesat e fshatit Fortesë.

Kurse Gëzim Mustafa, kryetar i këshillit të fshatit Pataqan i Ulët, i ka prezantuar kërkesat e këtij fshati sipas prioriteteve. "Rregullimi i proçkave të fshatit, rregullimi i kanalizimeve, kubëzimi i rrugëve, rregullimi i ndriçimit publik, rregullimi i trotuarit përgjatë rrugës kryesore të fshatit dhe rregullimi i rrugëve fushore", është shprehur Mustafa.

Edhe Naim Gashi, anëtar i këshillit të fshatit Sapniq, i ka prezantuar kërkesat e fshatit të



tij. Ai ka thënë se rregullimi i kanalizimeve të ujërave të zeza, rregullimi i ndriçimit publik, kubëzimi i rrugëve, rregullimi i rrugëve fushore dhe hapja e një rruge që lidh fshatrat Sapniq-

Fortesë janë kërkesa të tyre. Ndërsa edhe Murat Kryeziu, kryetar i këshillit të fshatit Xërxë, i ka paraqitur kërkesat e fshatit të tij. "Kubëzimi i rrugëve brenda fshatit, rregullimi i ndriçimit

publik, rregullimi i kanalizimit, ndërtimi i objekti të ri të shkollës, rregullimi i udhëkryqit afër shkollës, trajtimi i kanalit afër shkollës, rethimi i varrezave të fshatit", ka thënë Kryeziu.

Ismajli: Situata në Gjilan është nën kontroll, janë identifikuar burimet e fundit të infeksionit me Covid-19

GJILAN, 10 KORRIK (ER) - Komiteti Emergjent i Gjilanit për parandalimin e përhapjes dhe menaxhimin e pandemisë Covid-19 është takuar të premtën për të bërë vlerësimin, pas 27 rasteve të reja pozitive me këtë virus.

Nënkryetari Arbër Ismajli, i cili tash e katër muaj po udhëheq operacionet, ka thënë se situata është nën kontroll të plotë, duke shtuar se janë identifikuar burimet e fundit të infeksionit. Ai ka kërkuar nga qytetarët që të vazhdojnë t'i respektojnë masat në mënyrë strikte, për pastrimin e duarve sa më shpesh, mbajtjen e distancës dhe bartjen e maskave.

Epidemilogia dr. Burbuqe Shkodra ka thënë se numri i përgjithshëm i të infektuarve në periudhën katërmujore është



257, derisa ka pohuar se janë në pritje të rezultateve të mostrave

për regjionin e Gjilanit në datat 8, 9 dhe 10 korrik. Ajo ka thënë

se ditët e fundit situata është rënduar me shtimin e rasteve të

reja por, fatmirësisht, ka treguar se gjendja pacientëve që kanë rezultuar pozitivë me Covid-19 është stabile.

Shkodra ka bërë me dije se do të testohen vetëm rastet që janë të shtrirë dhe ata që kanë shfaqur simptoma.

Drejtori Klinik i Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit, anesteziologu dr. Ukshin Ismaili, ka theksuar se kapaciteti i këtij institucioni shëndetësor është 14 qasje të përnjëhershme me oksigjenoterapi, derisa ka shtuar se janë 50 shtretër ku mund të shtrihen rastet eventuale. Ai ka kërkuar nga qytetarët që kanë simptoma të këtij virusi, të lajmërohen në Spitalin e Përgjithshëm i cili është në shërbim 24 orë dhe 7 ditë në javë.

Kryesia e Rinisë e Nismës në Drenas kalon në AAK

DRENAS, 10 KORRIK (ER) - Kryesia e Rinisë e Nismës Socialdemokrate në Drenas të premtën i është bashkuar Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Të aderuarit i ka pritur në selinë e AAK-së, lideri Ramush Haradinaj, i cili ishte i shoqëruar edhe nga

deputeti Haxhi Shala. "Me deputetin Haxhi Shala dhe kryetarin e AAK-së në Drenas, Beqir Kiqina, i uruam mirëseardhje në familjen tonë të përbashkët, Edmond Thaçit me kolegë. Ai së bashku me kryesinë e deritashme të rinisë së Nismës në

Drenas kanë vendosur që rrugëtimin e tyre politik ta vazhdojnë në Aleancë. Dyertona janë të hapura për të gjithë ata që përqafojnë vizionin e Aleancës për vendin dhe për mirëqenien e të gjithë qytetarëve", ka thënë Haradinaj pas takimit.



A MOS JANË EDHE VETË EVROPIANËT QË PAGUHEN PËR KOSOVËN INFORMATORË TË SHPIFJEVE TË DICK MARTYT DHE SHPIFËS PËR TA NJOLLOSUR LUFTËN E KOSOVËS PËR ÇLIRIM?



Shkruan: Kudusi LAMA

Unë e dua integrimin. Po për ku? Këtë përgjigje duhet ta japin ata që marrin përgjegjësi të jenë drejtues të Evropës. Unë e dua bashkëpunimin, por me kë? Me Serbinë që thotë nuk dua të dijë nëse ekzistojnë ose jo shqiptarët, apo me Greqinë që po na nxjerrë edhe eshtrat nga varret në trojet tona, për të pretenduar se deri në Shkumbin është tokë greke? Ne e dimë që rreth 18 për qind e popullsisë brenda kufijve të shtetit të Shqipërisë janë të fesë së krishtere ortodokse. Po e di Evropa që Greqia vlerëson se çdo ortodoks është grek? Me këtë a mund të bashkëpunohet në këto kushte? A mos duhet që ne të pretendojmë se çdo mysliman i bardhë në Evropë është shqiptar? Nëse do të bënim këtë, do të vepronim e deklarim një lloj si grekët. Kjo nuk është e mundur të jetë Evropa e bashkuar dhe fuqi e botës, por një Evropë në degradim dhe me tendencë shkatërrimi, thjesht për t'i shfrytëzuar fuqitë e saj të brendshme evropiane për aktorët e kësaj skene që quhet Evropë. Më vjen keq, që Evropa e kulturës botërore ndjek interesat e përfituesve të pakaraktershëm.

Ne jemi të gatshëm të përfitojmë nga përvojat e evropianëve, por ato që janë vërtet përvoja, jo ato që na kthejnë edhe një herë në bazën e nisjes. Këtu duket se sa herë ndërrohet shtetësia e individëve që ndihmojnë në emër të Evropës, ka një devijim të ndihmës dhe një kthim prapa. A nuk e shohin evropianët këtë apo duan të jenë në këto pozicione? Ata që janë në Kosovë sot, në strukturat e EULEX-it, një punonjës i thjeshtë e ka pagën mujore sa dy a tre fish i pagës së kryeministrit apo presidentit të Kosovës. Po realisht çfarë bëjnë? Pse duhet të ishte Dick Marty ai që ta zbulonte trafikun e organeve njerëzore gjatë luftës, nëse ishte e vërtetë, pse të mos ishin evropianët që paguhen për Kosovën? Kjo duket si lojë volejboli, kur luhet duke i lënë topin në dorë njëri-tjetrit. A mos janë edhe vetë evropianët

që paguhen për Kosovën informatorë të shpifjeve të Dick Martyt dhe shpifës për t'i njollosur luftëtarët dhe luftën e Kosovës për çlirim?

Unë e di se Serbia është e sëmurë dhe vuan nga sëmundja e madhështisë, megalomanisë, hyjnizimit, mbisundimit etj. Por, shtroi pyetjen: a mos kanë dukuri të një sëmundjeje të tillë edhe të tjerë, si Franca, Anglia, Gjermania etj? Më duket se vërtet ka dukuri të mbisundimit edhe në këto politika, që realisht nuk desha të kishte, sepse kam shumë nderim për kulturën dhe historinë e këtyre shteteve.

Ne nuk kemi kërkuar të jemi pjesë e Evropës për t'u asimiluar, por për t'u identifikuar. Nuk kemi kërkuar ta ndërrojmë sunduesin, por të çlirohemi nga kolonizimi. Kush mendon se ne duhet të qëndrojmë akoma të kolonizuar me pushtues të ri, gabon rëndë. Ashtu sikurse ne nuk e kemi kërkuar Evropën për t'u bërë ndihmës në fuqizimin e dikujt. Jo, ne e duam Evropën, nëse ajo na do ne shqiptarëve, siç do gjermanët, britanikët, francezët, belgët, suedezët, italianët etj. Jashtë kësaj balance dashurie nuk mund të jemi shqiptarët të denjë për Evropën dhe Evropa e nevojshme për shqiptarët. Jemi

mësuar me armiqtë, mohim, përjashtim, ekspansion, grabitje, asimilim etj. Por, mjaft më.

Kam lexuar se: "Drejtësia është elementi më i rëndësishëm në ruajtjen e stabilitetit, rendit, qetësisë, paqes dhe bilancit në mesin e shoqërive njerëzore. Funksionimi i drejtësisë në mënyrë të drejtpërdrejtë nënkupton edhe funksionimin e respektit dhe vlerave njerëzore për të gjithë pa dallim, ndërsa ngritja dhe mosfunksionimi i saj në mesin e një shoqërie, pashmangshëm paralajmëron anarkinë dhe destabilitetin. Drejtësia është çelësi i qetësisë, kurse nëpërkëmbja dhe anashkalimi i saj është çelësi i turbullirave dhe i luftërave".

Do të kisha shumë dëshirë që të ishte mbajtur në konsideratë një ide e tillë që realisht nuk është e re. Prandaj edhe apeloj, që bashkësia ndërkombëtare, para se të bëjë politikë të vlerësojë drejtësinë. Po të bëhet një vlerësim në këtë këndvështrim, kuptohet që do t'i jepet haku gjithkujt. Po të vlerësohet drejtësia do të kërkohej për t'u gjetur të zhdukurit shqiptar e pastaj të pretenduarit serb.

Ky qëndrim është vërtet monstruozi. Serbia shtet, me infrastrukturë moderne

evropiane për të gjitha fushat, edhe për mjekësinë; me paramilitarë, ushtri e polici; me mjete tokësore, ajrore e detare; me rrugë e komoditete nga më të ndryshmet; me tregti të jashtme e të brendshme; me diplomaci e marrëdhënie ndërkombëtare komplekse; me shërbim informativ shtetëror, të policisë e të ushtrisë; me gazetarë, gazeta, televizione, radio e faqe interneti; me perandorinë Ruse në ndihmë etj.; dhe nuk paska asnjë kriminel, që të merret me veprimtari të paligjshme, nuk paska fare interesa për organet njerëzore për trafik e transplantime, nuk paska fare probleme kriminaliteti, ani pse, pasi na i kanë përdhunuar vajzat, i kanë rrjepur për të vlerësuar se kur njeriu ndjen më shumë kënaqësi, kur përdhunon apo kur rrjepë një njeri; ani pse, na i kanë nxjerrë nga barku i nënave foshnjat, për të parë se si reagon një nënë kur çlirohet nga foshnja e saj në këmbë, pa e ulur në tryzën e operacionit dhe në rrugë pa pasur nevojë për salla operacioni. Ani pse na i kanë vënë djemtë të përdhunojnë nënat e i kanë vënë nënat të hanë mishin e djemve të tyre të pjekur në prush; ani pse na i kanë vrarë mësuesit dhe trupat e tyre i kanë shkrirë me acid. I

kanë vrarë burrat e kufomat e tyre i kanë djegur nëpër furra të industrisë, apo të ngritura apostafat për këtë punë. Na i kanë përdhunuar femrat përpara burrave, baballarëve e vëllezërve të lidhur; na i kanë mbytur pleqtë nëpër puse e gremina; na i kanë... për të gjitha këto nuk ka ndonjë problem. A është e vërtetë se nuk janë problem për Evropën këto? Dua të di.

Shqetësimi është se disa djem patën rrëmbyer armët dhe i dolën zot atdheut, popullit dhe kombit të tyre. Këta djem nuk ishin të dëshirueshëm. Një herë u akuzuan se janë kriminelë, se janë agentë, se janë islamikë, se janë irredentistë, se janë me probleme, se janë marksistë leninistë, se duan të ndërtojnë një Kubë në Ballkan, se janë fundamentalistë, se janë hajdutë, se janë e ç' nuk janë. Na i thanë të gjitha. Por djemtë dhe vajzat me armë në malet e Kosovës nuk u mundën nga këto etiketime. Ata vazhduan luftën e tyre pa kompromis. Ata vazhduan të forcohen çdo ditë. Pas këtij momenti, iu dha leje Millosheviqit t'i zhdukë e të krijojë qetësi në Kosovë, në të kundërt nuk ishte përgjegjësia e askujt veçse e tij, nëse një ditë do të ballafaqohej me botën, pasi njëherë ishte falur në Bosnjë. (Vijon)



Guterresi: Edhe 25 vjet pas gjenocidit në Srebrenicë, paqja është e paqëndrueshme

NJU JORK, 10 KORRIK - Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, në një videomesazh për përvjetorin e 25-të të masakrës së Srebrenicës, ka thënë se ky ka qenë krimi më i keq masiv në tokën evropiane, pas Luftës së Dytë Botërore. "Njëzet e pesë vjet më vonë nderojmë mijëra të vrarët dhe zotohemi se nuk do t'i harrojmë kurrë. Bashkëndejmë vuajtjen e familjeve të tyre, përfshirë të atyre që kanë ende familjarë të pagjetur", ka deklaruar Guterres. Ai shtoi se një çerek shekulli më parë Kombet e Bashkuara dhe bashkësia ndërkombëtare i

tradhtuan qytetarët e Srebrenicës. Siç ka thënë ish-sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Kofi Anan, ky lëshim "do ta ndjekë gjithmonë historinë tonë", ka thënë Guterres. Në korrik të vitit 1995 forcat serbe të Bosnjës kanë vrarë mbi 8 000 burra dhe djem myslimanë në Srebrenicë, zonë që ishte shpallur e sigurt nga Kombet e Bashkuara. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë ka konstatuar në vitin 2007 se vrasjet në Srebrenicë kanë përbërë gjenocid. Gjykata e Kombeve të Bashkuara për Krimet e Luftës në ish-



Jugosllavi ka dënuar ish-komandantin e forcave serbe të Bosnjës, Ratko Mlladiq, dhe mentorin e tij politik, Radovan

Karaxhiq, për gjenocid dhe krime të tjera të luftës në Srebrenicë.

Guterres u bëri thirrje të gjithëve në rajon dhe më gjerë që ta parandalojnë gjuhën e urrejtjes, retorikën e përçarjeve, mosbesimin dhe frikën. "Në këtë përvjetor të errët, kujtohem se paqja në Bosnje dhe Hercegovinë është ende e paqëndrueshme. Nuk mund të mos vazhdojmë të punojmë për pajtimin e përgjithshëm. Këtë ua kemi borxh viktimave të gjenocidit në Srebrenicë, të mbijetuarve, qytetarëve të Bosnjës dhe gjithë njerëzimit", ka thënë Guterres.

OBSH-ja: Koronavirusi ka dalë jashtë kontrollit

GJENEVE, 10 KORRIK - Kreu i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Tedros Adhanom Ghebreyesus, ka thënë se shpërthimi i pandemisë Covid-19 vazhdon të mbetet problem për shkak se në shumicën e vendeve të botës nuk është vënë ende nën kontroll. Teksa ka folur në një konferencë për media, Tedros u shpreh se deri më tani më shumë se 11.8 milionë raste me koronavirus janë raportuar agjencisë së shëndetit në OKB, gjysma prej tyre në gjashtë javët e fundit.

Më tej ai shtoi se pandemia ka ekspozuar pabarazitë globale dhe kombëtare si në sistemet e shëndetësisë, po ashtu edhe në shoqëri. E ndërsa në shumë vende ka shpërthyer një valë e



dytë infektimesh me koronavirus, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është regjistruar një tjetër rekord i zi. Gjatë 24 orëve të fundit janë

shënuar më shumë se 65 mijë raste të reja me Covid-19. Në ShBA numërohen mbi 3.2 milionë të infektuar, duke e bërë ShBA-në vendin me numrin më

të lartë të rasteve dhe vdekjeve. Gjithashtu, raportohet se në tri ditët e fundit është rritur edhe numri i viktimave nga koronavirusi. Sipas autoriteteve, në tri ditët e fundit janë raportuar më shumë se 900 viktima. Për këtë situatë nuk duket shumë i shqetësuar presidenti Donald Trump i cili thotë se shifrat janë rezultat i numrit të madh të testeve që janë bërë.

Ndërsa në kontinentin evropian, maskat dhe frika nga vala e dytë e koronavirusit janë kthyer në kryefjalë. Tani të gjithë personat mbi moshën gjashtëvjeçare në Kataloni duhet të mbajnë një maskë në publik.

Në Francë po shtohen


shqetësimet për një valë të dytë të epidemisë, ndërkohë që vendi po zbut kufizimet. Pas 137 ditësh, njësitë e kujdesit intensiv në një spital në një zonat më të goditura të Italisë nga pandemia, Bergamo, zyrtarisht nuk kanë asnjë rast pozitiv me Covid-19. Në të gjithë botën numri i përgjithshëm i rasteve të identifikuar me koronavirus është rritur në më shumë se 12 milionë e 200 mijë, ndërsa totali i viktimave, që nga fillimi i pandemisë, është 550 mijë. Renditjen e grafikut të pandemisë në botë e udhëheqin Shtetet e Bashkuara me më shumë se 3 milionë raste me Covid-19, e ndjekur nga Brazili, India, Rusia dhe Peruja.

Gjykata e Lartë në ShBA vendos për taksat e presidentit Trump

Nju Jork, 10 korrik - Gjykata e Lartë e ShBA-së e ka bërë të qartë se një prokuror i qytetit të Nju Jorkut ka të drejtë t'i shikojë të dhënat financiare të presidentit Donald Trump, por vendosi të mos lejojë, të paktën tani për tani, që Dhoma e Përfaqësuesve, e drejtuar nga demokratët, të marrë të dhëna të ngjashme financiare. Të dyja vendimet, të marra me shtatë vota për dhe dy kundër, ishin hartuar nga kreu i Gjykatës së Lartë, John Roberts. Njëri vendim nënkupton se kërkesa e bërë në adresë të

firmës së kontabilitetit Mazars LLP, e përdorur nga presidenti Trump, që ajo t'i dorëzojë një jurie të madhe dokumentet e ndryshme financiare të presidentit, si pjesë e një hetimi kriminal, duhet të zbatohet. Por Gjykata e Lartë la mënjanë vendimin e rëndësishëm nëse tre komisione të Dhomës së Përfaqësuesve mund të marrin gjithashtu, kundrejt kërkesës zyrtare, dokumentet financiare të presidentit Trump.

Ajo praktikisht rrëzoi vendimet e gjykatave më të ulëta që përcaktonin se disa komisione



të kongresit të drejtuar nga demokratët kanë të drejtë t'i marrin dokumentet financiare

të presidentit. Gjykata e Lartë ua ktheu këtë çështje gjykatave më të ulëta për

rishqyrtim, gjë që shënon një fitore të përkohshme për presidentin Trump.

Presidenti Trump, i cili nuk ka ndjekur praktikën e kandidatëve të tjerë presidencialë, duke refuzuar t'i bëjë publike dokumentet tatimore gjatë fushatës së vitit 2016, është përpjekur ta bllokojë publikimin e dokumenteve të tij financiare. Disa komisione të Dhomës së Përfaqësuesve kishin kërkuar të dhëna për këto dokumente nga dy banka, Capital One dhe Deutsche Bank, si dhe nga firma e kontabilitetit Mazars USA.

Dhjetë të vdekur nga koronavirusi në Novi Pazar

Novi Pazar, 10 korrik - Dhjetë persona kanë vdekur në Novi Pazar të Serbisë gjatë natës ndërmjet të enjtes dhe së premtes për shkak të koronavirusit. Kështu ka bërë me dije për

TV Prva, Mirsad Gjerlek, koordinator në spitalin e Novi Pazarit. Ai ka thënë se viktimat janë mbi moshën 75-vjeçare, por ka theksuar se situata me koronavirus në këtë qytet të Serbisë është

duke u stabilizuar. Sipas Gjerlekut, mbi 80 persona janë shëruar nga Covid-19, sëmundja që e shkakton koronavirusi. Ai ka theksuar se 290 pacientë janë të shtrirë aktualisht në spital.

Ky numër i të shtrirë në spital është më i vogël krahasuar me një ditë më parë, kur ishin të shtrirë 370 pacientë. Novi Pazar është ndër qytetet më të prekura nga koronavirusi në Serbi.



(Fjalim në emër të Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës)

TË GJITHË ATYRE QË VIJNË TË NA VRASIN VDEKJEN DUHET TË UA JAPIM

Ismet SYLEJMANI

Motra dhe vëllezër,

Familje e nderuar e të ndjerit Fehmi Ademi!

Dhuna dhe terrori që po ushtron sot mbi popullin shqiptar nën Jugosllavi, nga shovenistët serbo-maqedonomalazezomëdhenj, është gjenocid i paparë, i cili e len nën hije edhe fashizmin dhe nazizmin e perënduar.

Neoqetniket e Slllobës dhe ata të Sheshelit, po na vrasin kudo që arrijnë!

Numri i atyre që na i morrën plumbat e tyre vrastare, me shpejtësi po i afrohet trefishorit.

Kurse ne, ka kohë që përballë këtij terrori të shfrenuar të xhelatëve çetniko serb, kemi rënë

gratë e tij!

Nuk duhet kohë e gjatë, kur mund të na therrin si bagëtinë me thikë e bajonetë, dhe kësh-tu të kursejnë edhe municionin, sepse edhe këta janë po ata të djeshmit, xhelatet e stara Serbisë!

Kjo sigurisht se do të na gjejë, po qe se ne vazhdojmë të preferojmë rrugën vdekjepruëse të durimit, sigurisht të sjellur nga të huajt, pasi që kjo, s'përkon me traditën e pasur të qëndresës heroike të popullit tonë lirishtash!

Nuk kemi njerëz të tepërt motra dhe vëllezër,

të ushqejmë orekset e smuara kanibaliste të neoqetnikëve millosheviqian dhe të atyre sheshelian!

Është koha kur duhet ta kurse-



në durimin absurd!

Si mjet bashkohorë të kundërvënies dhe falë këtij durimi edhe gjakftohësisë po arrijnë suksese kriminelët, në realizimin e detyrave të tyre prej vrasësi të paguar për historinë!

Por jo, edhe ne si kundërshtarë të këtij terrori, edhe tubimet e këtilla ku mblihdemi për të ndarë dhembjen dhe njëherit të protestojmë, aq sa na lejon armiku, janë bërë gjë e zakonshme që si prishin kujt rehatinë, e lere më ti pengojnë në realizimin e planeve të tyre shfarosëse!

Dita ditës po shëndrrohem nga një popull trim e luftarak, në një turmë vajtuëse, qe edhe vajet e së cilës treten si zëri i të humburit në shkretirë!

Kjo veq ka filluar të na vret, vrasja e shqiptareve është bërë dukuri e zakonshme, shqiptari më s'është i sigurtë as në shtëpinë e vet, sika të sigurtë as fëmijët, as pleqt, as burrat e

jmë veten nga vdekjet e këtilla, që e sjellin atë vdekjen e madhe shuarjen e kombit, e cila megjithatë kurrë s'do të na gjejë!

Nuk është herët, në mos qoftë vonë, që t'gjitha subjektet politike të veprojnë ndër shqiptarët, e sidomos Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Partia për Prosperitet Demokratik, të cilat thirren se gëzojnë besimin e popullit, të angazhohen jo vetëm për organizimet e tyre partiake, por edhe për një organizim gjithëkombëtar, për të iu kundërvënë në mënyrë adekuate terrorit dhe dhunës së paparë që po ushtrohet mbi këtë popull të pafajshëm!

Tingellojnë ironike thirrjet për kundërvënje civilizuese gjakftohësi e durim, barbarizmave të shfrenuara çetniko fashiste të policisë serbe!

Vëllezër dhe motra,

Vrasësit e pa ndjenja, nuk do të



arrijmë ti bindim për t'hjekur dorë nga krimet, në saje të qijave ata po zgjasin jetën e tyre prej kriminelit, pa iu pergjigjur në të njëjtën menyrë.

Prandaj Lëvizja Popullore e Republikës së Kosovës, thërret, të gjitha partitë dhe organizatat politike, të bashkohen si një grusht, dhe me masa konkrete ti dalin përpara, njëherë e mirë, për të ia ndërprerë turrin këtij përbindeshi prehistorik.

Sot, kur janë të rrezikuara

interesat jetike të popullit shqiptar, kemi arsye më shumë se asnjëherë më parë, të thirremi në porosinë e tij, zjarrit me zjarr, plumbit me plumb! Pra, të gjithë atyre që vijnë të na vrasin vdekjen duhet tua japim!

Lavdi dëshmorëve në luftë për liri!

Ismet Sylejmani, Anëtar i Komitetit Drejtues i Lëvizjes Popullore për Republikën e

Kosovës-LPRK, i prezentuar me emer ilegal (Hysen Ramadani)

Prishtinë 2 Qërshor 1991!*p.s: ky fjalim botohet i plotë për herë të parë pas 29 viteve, dhe kjo bëhet duke e falenderuar djalin e martirit Fehmi Ademi, të nderuarin Gani Ademi, i cili na e ka siguruar shiritin e videos të ditës së varrimit!***Prishtinë, me 10.07.2020**

E rrallë

Itali, nuset protestojnë ndaj pezullimit të dasmave



Një shoqatë italiane e dasmave ka organizuar një manifestim të pazakontë, me 15 vajza të veshura me fustane nusërie, të cilat

kanë parakaluar rrugëve në shenjë proteste ndaj masave kufizuese për shkak të koronavirusit. Një protestë e tillë është

mbajtur pasi Shoqata e Dasmave AIRB ka bërë me dije për humbjet në sektorin e organizimit të dasmave.

BARSOLETA E DITËS



Në shkollë mësuesja po shpjegonte:
- Unë studioj, ti studion, ai ajo studion.
Çfarë kohe është Toni?
- Është kohë e humbur kot, mësuese!



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

E jashtëzakonshme

Hodhi 3 mijë euro në mbeturina, punëtorët e kompanisë së pastrimit ia kthejnë



Dy persona të cilët mbledhin mbeturina gjetën diçka shumë të vlefshme. Brenda një kolltuku fshihej një shumë e konsiderueshme parash. Të hollat nuk hezitan t'ia kthejnë pronarit i cili, në shenjë falënderimi, të

dye ua dha nga 100 dollarë. E punëtorët që hoqën mbeturinat e kuptuan se aty ka para vetëm pasi i kontaktoi pronari i parave. Aty fshiheshin rreth 2500 dollarë, 1 000 euro dhe disa para të valutave të tjera.

FOTO E DITES



Komuna e Prishtinës ka vendosur kabinat e reja për pritjen e autobusëve



DASHI
Ekziston rreziku që

dikush të reagojë më fort se sa duhet për diçka që do të thoni sot.



DEMI
Në vend se ta harxhoni kohën

nëpër klube me miqtë, organizoni ndonjë udhëtim që do t'ju mbushë me frymëzim.



BINJAKËT
Puna në grup do t'ju marrë të

gjithë kohën tuaj dhe do t'ju harxhojë energjinë, por destinacioni do të jetë i suksesshëm.



GAFORRJA
Prisni që të filloni këtë ditë

me shumë energji të lartë. Ka shumë emocione, ide dhe optimizëm në kokën tuaj.



LUANI
Modestia mund të ju ndalojë që t'i

mburreni botës për suksesin tuaj të fundit, por kjo nuk do t'i pengojë miqtë dhe të dashurit tuaj që t'ju përgëzojnë.



VIRGJËRESHA
Do të ofrohet shumë

ndihmë për ju, por ju nuk keni nevojë ta merrni atë nëse nuk dëshironi.



PESHORJA
Bashkohuni me një grup

njerëzish që punojnë për ta bërë botën më të bukur! Bëni diçka për ta bërë komunitetin tuaj më të mirë.



AKREPI
Edhe nëse koha është më pak se ideale,

ju do të jeni në gjendje të merrni një nxitje të fortë nëse mbushni trurin me energji të pastër.



SHIGJETARI
Është një gjë të jeni

fleksibël, por është diçka tjetër që dikush ta shfrytëzojë mirësinë tuaj.



BRICJAPI
Nëse njerëzit rreth

jush reagojnë në një situatë të pakëndshme, mos e ndiqni shembullin e tyre.



UJORI
Mundohuni të shtoni më shumë

stërvitje në rutinën tuaj të përditshme. Ju jeni përgjegjës për fizikun tuaj.



PESHQIT
Tani për tani, jeta juaj

mund të jetë si një shfaqje e mrekullueshme. Kjo është një kohë mjaft e frytshme për jetën.

Fotografi shokuese të Johnny Deppit para gjykatës



Foto shokuese të jetës kaotike me droga dhe alkool janë shfaqur në Gjykatën e Lartë në Londër, ku ylli i Hollywoodit, Johnny Depp, është në betejë ligjore me gazetën britanike "The Sun" dhe ish-gruan Amber Heard. Protagonisti i filmit "Piratët e Karaibeve" ka paditur gazetën që e

ka quajtur "rrahës i grave", për çka Depp ka thënë se janë pretendime "të sëmura dhe të pavërteta". Depp pranon se ka përdorur kokainë dhe ka thënë se ish-gruaja e tij shfrytëzon përdorimin e drogave për ta quajtur "monstër". Në fotografi tregohet masa e vërtetë e abuzimit të Deppit me substancat.

Hapet ditari sekret i Michael Jacksonit, ëndërronte të bëhej i pavdekshëm



Njëmbëdhjetë vjet nga vdekja e Michael Jacksonit vazhdojnë të dalin sekrete për mbretin e popit. Një libër i ri, që ka mbledhur të dhëna nga ditari i tij, tregon në fakt se si Jacko kishte planifikuar të bëhej i pavdekshëm. Pak para se të vdiste kishte si objek-

tiv të arrinte edhe Hollywoodin dhe të bëhej kështu 'artisti-aktori-regjisori miliardër'. Sipas asaj që raportohet në librin e ri, i publikuar ekskluzivisht nga "Mirror", disa muaj përpara vdekjes së tij, Jacko shpresonte të bëhej sa më shpejt një yll kinemaje.



Aktori Shia LaBeouf mbështet kandidatin demokrat Joe Biden

Ylli 34-vjeçar i Peanut Butter Falcon, Shia LaBeouf, u pa duke treguar mbështetjen e tij për kandidatin demokrat për president të Amerikës, Joe Biden, teksa u


fotografua mëngjesin e të enjtes në Los Anxhelos. Shia u pa i veshur me një maskë në fytyrë mes pandemisë Covid-19 mbi të cilën shkruhej Biden.

Ende asnjë gjurmë e aktores Naya Rivera, ish-burri i saj fotografohet me djalin e tyre



Ish-burri zemërthyer i Naya Riveras, e humbur pa gjurmë, u pa për herë të parë duke ngushëlluar djalin e vogël vetëm një ditë pasi aktorja Glee u zhdruk në një liqen në Kaliforni, ku ajo po luante me djalin katërvjeçar. Babai i Ryan Dorsey u vu re duke mbajtur Joseyn në krahë, ndërsa ata u

larguan nga shtëpia e motrës së Nayas, modelueses Nickayla Rivera në Valencia, Kaliforni, të enjten, shkruan "DailyMail". Dorsey, i cili ka kujdestarinë e përbashkët të djalit të tij pasi ai u nda nga ylli i Glee, Naya, në qershor të vitit 2018, u mërzi dukshëm gjatë ditës, ndërsa u zgjua për realitetin e asaj që kishte ndodhur.



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Bytyqi: Paraqitja në garat ndërkombëtare, një ëndërr që u bë realitet

Basketbollistja Valbona Bytyqi është e lumtur se Kosova do të marrë pjesë në garat ndërkombëtare edhe me Përfaqësuesen A të femrave. “Është një ëndërr që u bë realitet. Më vjen keq për bashkëlojtaret që e kanë përfunduar karrierën pa e veshur fanellën e Përfaqësueses, që për çdo sportist është ëndërr. Personalisht ndihem shumë e lumtur dhe me padurim pres ftesën që të jemi së bashku me bashkëlojtaret më të mira që ka vendi”, ka thënë Bytyqi



që për çdo sportist është ëndërr. Personalisht ndihem shumë e lumtur dhe me padurim pres ftesën që të jemi së bashku me bashkëlojtaret më të mira që ka

vendi. Një falënderim shkon edhe për Federatën e Basketbollit të Kosovës, përkatësisht sekretaren e përgjithshme Elvira Dushku, që

hapën dyert për Përfaqësuesen A të basketbollit të femrave. Është një ditë e rëndësishme për basketbollin e femrave në Kosovë”, ka thënë Bytyqi për faqen zyrtare të FBK-së.

Në FIBA Kampionatin Evropian për Shtetet e Vogla-Femrat në vitin 2020 janë paraqitur për të garuar: Andorra, Qipro, Gjibraltari, Irlanda, Luksemburgu, Malta dhe Norvegjia, por që u anulua për shkak të pandemisë Covid-19. Regjistrimi i shteteve për pjesëmarrje në FIBA Kampionate Evropiane në FIBA Europe do të bëhet si zakonisht, pra ndërmjet muajve shtator/tetor 2020. FIBA Evropa ka kërkuar nga të gjitha Federatat Nacionale që t'i regjistrojnë ekipet e tyre për vitin 2021, pasi regjistrimet e paraqitura për vitin 2020 nuk do të merren parasysh.

PRISHTINË, 10 KORRIK - Komuniteti i basketbollit është duke e mirëpritur vendimin e Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) që Kosova A (femrat) të paraqitet zyrtarisht në garat ndërkombëtare. Kosova pritet të marrë pjesë në FIBA Kampionatin Evropian të Shteteve të Vogla që do të organizohet në vitin e ardhshëm në Nicosia të Qipros prej 15 deri

më 20 qershor. Një nga basketbollistët më me përvojë në Kosovë është Valbona Bytyqi. Ajo ka folur rreth formimit të Përfaqësueses A në konkurrencën e femrave dhe paraqitjen në arenën ndërkombëtare. “Është një ëndërr që u bë realitet. Më vjen keq për bashkëlojtaret që e kanë përfunduar karrierën pa e veshur fanellën e Përfaqësueses,

Demaj: Sërish do ta mposhtim Italinë



PRISHTINË, 10 KORRIK - Kapitenia e Përfaqësueses së Kosovës në hendboll, Leonora Demaj, ishte e pandalshme në ndeshjen e fituar ndaj Italisë vitin e kaluar. Me Italinë, Kosova do të përballet sërish në fund të vitit, në kualifikimet për Botërorin 2021. Në grup me “dardanet” është Austria, kurse ndeshjet do të luhen në Austri në fund të nëntorit apo fillim të dhjetorit. Liderja e Kosovës, Demaj, nuk

shih arsye për të mos fituar sërish ndaj Italisë. Fitorja do të mjaftonte për të kaluar në fazën tjetër kualifikuese. “Italinë e kemi mposhtur, prandaj nuk shoh arsye pse të ndryshojë kjo. Austria është ekip mjaft i fortë dhe ka lojtare me përvojë. Mirëpo ne kemi bërë befasi më parë dhe do të ishte kënaqësi nëse ndodhë përsëri”, ka thënë Demaj për faqen zyrtare të FHK-së. “Në Kombëtare ne

luajmë me zemër dhe nuk dorëzohemi deri në sekondën e fundit. Pres që vajzat ta japin maksimumin dhe të luftojmë për njëra-tjetrën. Më pas do të shohim se ku jemi kur të mbarojë loja. Shpresoj dhe besoj se me lojë të mirë, me luftë, mund ta arrijmë vendin e dytë. Kush e di, ndoshta edhe vendin e parë”, ka shtuar Demaj, e cila është duke sanuar një lëndim të gjurit.

Reims: Valon Berisha është lider i lindur

REIMS, 10 KORRIK - Stade de Reims e ka zyrtarizuar të enjten në mbrëmje transferimin e Valon Berishës, i cili nënshkroi kontratë katërvjeçare. Berisha në klubin francez iu bashku yllit tjetër të Kosovës, Arbër Zeneli. Ndërsa drejtuesit e Stade de Reims e vlerësojnë potencialin që ka Berisha dhe presin që futbollisti nga Kosova të luajë sikurse bënte në

skuadrën e Red Bull Salzburgut. “Transferimi i Valon Berishës i tregon të gjitha ambicidet dhe influencën në rritje të Stade de Reims”, ka thënë Mathieu Lacour, drejtor sportiv i klubit francez. “Ishte ai dhe askush tjetër. Shpresojmë që ai do të luajë si në kohën e artë në Red Bull Salzburg, kur kishte luajtur në Ligën e Evropës. Ai ka bërë

përvojë në garat evropiane. Ne ia urojmë mirëseardhjen dhe mikpritjen këtij lojtari me përvojë, i cili ka shfaqur interesim të vazhdueshëm për projektin tonë. Fakti se ai do t'u bashkohet shokëve vetëm pak ditë pas pushimit është mjaft pozitive për integrimin e tij të ardhshëm. I urojmë mirëseardhje këtij lideri të lindur!”, ka shtuar Lacour.



Munishi vendos të heshtë për pjesën finale të sezonit

Suharekë, 10 korrik - Trajneri i Ballkanit, Ismet Munishi, në pjesën finale të sezonit në futboll, ka vendosur të mos marrë pjesë në emisionit televizive dhe të mos pronco-

het për media. Lajmin e ka konfirmuar vetë Munishi nëpërmjet një postimi në “Facebook”. Ai ka bërë me dije se ka vendosur që të përqendrohet vetëm në skuadrën e

Ballkanit. “Deri në afat të pacaktuar nuk do të jem pjesë e asnjë emisioni ose debati sportiv. Besoj se deri këtu kam qenë shumë korrekt me mediat. Dua që gjithë energjinë

time ta orientoj kah skuadra ime, Ballkani. Me shpresë se do të ketë çka të analizohet në xhirot e ardhshme dhe analizat të jenë korrekte nga analistët”, ka shkruar Munishi.

Werder Bremeni konfirmon se Rashica do të largohet

BREMEN, 10 KORRIK - Werder Bremeni ka nisur bisedimet me disa klube për shitjen e Milot Rashicës. Lajmin e ka konfirmuar drejtori sportiv Frank Bauman, i cili ka bërë

me dije se Milot Rashica e ka informuar klubin se dëshiron të largohet këtë verë. "Përveç Rashicës që dëshiron ta bëjë hapin e madh në karrierë dhe na ka njoftuar largimin,

asnjë lojtar tjetër nuk ka shprehur dëshirën për largim. Ka bisedime me një klub, por ka edhe klube të tjera të interesuara për Rashicën. Ai na ka lajmëruar

se nuk do të jetë më me ne sezonin tjetër", ka thënë Bauman. Interesim për Rashicën kanë shfaqur RB Leipzig, Borussia Dortmund, Lazio, Napoli dhe Milan.



Shorti i Ligës së Kampionëve rezervon çerekfinale dhe gjysmëfinale të 'zjarrta'

LISBONË, 10 KORRIK - Do të rinisë gjithçka më 7 dhe 8 gusht me ndeshjet e kthimit që ende nuk janë zhvilluar në 1/8 e finaleve dhe më pas sprinti që do të impenjojë të mbijetuarit e Ligës së Kampionëve nuk do të ndalet deri në finalen e madhe më 23 gusht. UEFA zbuloi, përmes një shorti virtual të ndikuar nga pandemia, edhe pjesën e mbetur të kalendarit për "Final 8", mënyrën e zgjedhur për ta kompletuar turneun me të gjitha ndeshjet në Lisbonë.

Në lidhje direkte me njëritjetrin, përfaqësuesit e klubeve që mezi dalloheshin përtej maskave që i mbrojnë nga koronavirusi, mësuuan edhe shortin. Cilido prej Realit të Madridit apo Manchester Cityt në fazën tjetër do të përballlet me fituesin e çiftit Juventus-Lyon. Atalanta do t'i masë forcat me PSG-në në një duel të cilësuar si Davidi dhe Golia, ndërsa Lajpcigu në një ndeshje të vetme si të tjerët, kundër Atleticos, raporton "tch". Napoli dhe Barcelona do ta zgjidhin fituesin mes tyre për t'u përballur më pas me atë që do të dalë nga beteja mes Chelsea-Bayern. Çerekfinalët do të luhen nga 12 deri më 15 gusht dhe gjysmëfinalët 3 ditë më vonë, në një mbingarkesë fizike, ku do të dallojë se kush



ka muskujt më të fortë mbi teknikën. Do të luhet në stadiumet e Lisbonës, në Zhoze Alvalade të Sportingut, dhe në impiantin Da Luz që do ta presë finalen e madhe në 23 gusht.

Faza çerekfinale:

Manchester City/Real Madrid - Juventus/Lyon
RB Leipzig - Atletico Madrid
Barcelona/Napoli - Bayern Munich/Chelsea
Atalata - PSG

Faza gjysmëfinale:

Manchester City/Real Madrid - Juventus/Lyon - Barcelona/Napoli
- Bayern Munich/Chelsea
RB Leipzig - Atletico Madrid - Atalata - PSG

Finale:

RB Leipzig - Atletico Madrid - Atalata - PSG VS Manchester City/Real Madrid - Juventus/Lyon - Barcelona/Napoli - Bayern Munich/Chelsea

Short me fat për Unitedin, Interi mund të përballlet me Leverkusenin

NYON, 10 KORRIK - Pas Ligës së Kampionëve, edhe Liga e Evropës është njohur me përballjet e fazës çerekfinale që do të nisë më 5 gusht dhe do të mbyllet më 21 të këtij muaji. Shorti përcaktoi rivalët e ardhshëm të Interit, që më parë duhet ta vendosë kualifikimin në përballjen tjetër kundër Getafes. Nëse kalojnë raundin, zikaltrit do të luajnë me fituesin e sfidës Bayer Leverkusen-Rangers. Me shumë mundësi do të jenë gjermanët, që në ndeshjen e vajtjes kanë fituar me rezultatin 3-1. Ndërsa shorti më i lehtë duket për skuadrën e Manchester Unitedit, sepse nëse do të kalojë LASK-un, Unitedi do ta sfidojë fituesin e ndeshjes mes Copenhagen dhe Basaksehir. Fituesi i çiftit Wolves-Olympiacos



do ta sfidojë fituesin e duelit tjetër tjerë në çerekfinalët e Ligës së Evropës që do të zhvillohen në Gjermani. Goglat kanë projektuar edhe ndeshjet e çiftet e

SHKURT

Kryeziu rezulton pozitiv me Covid-19

Mbrojtësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Mirlind Kryeziu, ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Lajmin e ka kumtuar në faqen zyrtare klubi i tij FC Zurich. "Qendërmbrojtësi i FCZ, Mirlind Kryeziu, ka dalë pozitiv me koronavirus sot. Që nga paraqitja e simptomave të buta, ai nuk ka marrë pjesë në stërvitje dhe është në vetizolim në shtëpi. Deri në një njoftim tjetër nuk do të marrë pjesë në stërvitje", është njoftuar nga klubi. 23-vjeçari është ftuar në disa raste nga Përfaqësuesja A e Kosovës, por ende nuk ka debutuar.

Formula 1 konfirmon edhe dy pista të tjera në kalendar

Federata Ndërkombëtare e Automobilizmit ka konfirmuar edhe dy gara të tjera në kalendarin e saj provizor për Botërorin 2020 të Formula 1. Pas tetë garave të para, ka ardhur konfirmimi për garën e 9-të dhe atë të 10-të. Gara e nëntë do të zhvillohet në pistën italiane të Mugello, më 13 shtator. Kjo garë përkon edhe me garën numër 1000 të Ferrarit në Formula 1, që praktikisht do ta zhvillojë atë në pistën e saj. Ndërsa gara e 10 do të zhvillohet më 27 shtator, në Sochi, Rusi. Për shkak të situatës aspak të mirë në Portugali, gara e planifikuar për t'u zhvilluar aty, në pistën e Portimao, ende është në dilemë. Po ashtu, në dilemë janë edhe garat jashtë Evropës, ato që mund të zhvillohen në Lindjen e Mesme apo Azi.

Ancelotti: Jamesi qëndron në Real

Prej kohësh është duke u përforcuar transferimi i James Rodriguezit në Everton, por kjo gjë duket se nuk do të ndodhë. Trajneri i Evertonit, Carlo Ancelotti, ka thënë se futbollisti kolumbian është një lojtar i madh, por ai do të qëndrojë në Real Madrid. "James është një lojtar i madh dhe Evertoni për sezonin e ardhshëm do të kërkojë futbollistë cilësorë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se do ta marrim Jamesin. Kam bindjen se ai do të qëndrojë në Madrid. Ai është lojtari i tyre dhe do të jetë edhe në të ardhmen. Evertoni? Duam lojtarë kampionë. Nuk ka rëndësi moshja e tyre", ka thënë Ancelotti.

Përfundon sezoni për Hendersonin

Kapiteni i Liverpoolit, Jordan Henderson, do të qëndrojë jashtë fushave deri në fund të sezonit, pas një dëmtimi në gju. Lajmi u konfirmua nga trajneri Jurgen Klopp. Henderson shënoi në fitoren 3-1 ndaj Brajtonit përpara se të largohej nga fusha i dëmtuar. Klopp tha se mesfushori anglez do ishte gati për ndeshjet e mbetura të sezonit, por nuk ia ka dalë dot. Por për Hendersonin ka edhe një lajm të mirë, pasi ai nuk do duhet t'i nënshtrohet ndonjë operacioni. "Nuk është diçka e këndshme, por është më e mira që mund të merrim", ka thënë Klopp.

Conte paralajmëron largimin nga Interi

Barazimi kundër Veronës ishte sfida e dytë që Interi nuk mundi të fitonte radhazi. Antonio Conte në prononcimin për mediat në fund të ndeshjes trembi tifozët e Interit për sa i përket të ardhmes duke lënë të kuptohet se në fund të këtij sezoni do të ketë ndryshime të mëdha në klub. "Këtu po bëhet një punë e madhe dhe kjo shihet, por fakti që kemi humbur 20 pikë nga situata kur ishim në avantazh, na bën që të reflektojmë dhe të përmirësohemi. A ka nevojë për kampionë skuadra? Nuk do të flas, pasi nëse e bëj, ju do të më masakroni. Unë do t'i bëj vlerësimet e mia në fund të sezonit ashtu si edhe klubi. Nëse ka diçka për t'ia thënë shoqërisë, do t'ia them. Të gjithëve u pëlqen të fitojmë, por duhet kuptuar nëse jemi afër apo larg të fituarit. Nëse shohim numrat, sheh që kemi posedim të lartë të topit, por në fund vlen rezultati dhe ne kemi humbur pikë me Sassuolon, Bolognan dhe Veronën", u shpreh Conte.

SHPALLJE PËR SHITJE

Ndërmarrja e Re "MIM Golesh" Magure

Ndërmarrja e Re (N.R.) "MIM Golesh", Magure e cila është në Administrim të Drejtpërdrejt të AKP-së, **SHPALLË** këtë:

FTESË PËR OFERTË
PËR SHITJEN E MATERIALEVE

EMRI ZYRTAR: Ndërmarrja e Re "MIM Golesh"

ADRESA POSTARE: Magure

I. LËNDA E KONTRATËS;

Autoriteti kontraktues ka për qëllim shitjen e materialeve si vijon:

1. Dunit I thërrmuar, fraksion 0 – 4mm , rreth 13800 m³,
2. Dunit I thërrmuar, fraksion 4 – 8 mm , rreth 2500 m³,
3. Dunit I thërrmuar, fraksion 8 – 11 mm rreth 1100 m³ dhe
4. Shkëmbinj ultrabazik (material për mbushje), fraksion – 60 mm , rreth 36700 m³

II. KUSHTET E OFERTIMIT:

1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit, numrit fiskal, certifikata e TVSH-se, numrin e telefonit kontaktues dhe adresa. Oferta duhet të përmbaj çmimin me TVSH, duhet të jete shume e qartë dhe të përfshijë të gjitha detajet e kërkuara, e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik;

III. VIZITA E MATERIALEVE

Palët e interesuara, materialet e larte cekura mundë ti shikojnë prej datës 07.07.2020 deri me 12.07.2020 prej orës 10:00h deri në orën 14:00h përmes personit kontaktues z. Shefik Imeri, nr. tel mob. 049/455-869 ose fix. 038/588-700.

IV. KRITERET PER DHENJEN E KONTRATES:

1. Çmimi më i lartë i ofruar për m³ të materialit

V. AFATI KOHOR DHE VENDI PER DOREZIMIN E OFERTAVE

Ofertat finale të cilat duhet të jenë në zarf të mbyllur, duhet të dërgohen me datën **13.07.2020** nga ora **13⁰⁰** deri në orën **14⁰⁰** në adresën e mëposhtme: Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. Agim Ramadani nr.08.

Ofertat do të hapen me datë **13.07.2020** në ora **14¹⁰** në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, rr. Agim Ramadani nr.08,.

VI. Përfaqësuesit legjitim të ofertuesve, mund të marrin pjesë me rastin e hapjes së ofertave.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Aksa Beyza Kryemadh shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf " Abdyl Frashëri " Prizren .

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentsisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Granit” Sh.p.k Istog, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e betonit në Suhadoll, Graçanicë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 04.08.2020 në ora 11:30 në hapësirat e restorant pizzeria “Hib Petrol” te rrethi QMI në anën e djathtë të rrugës Lipjan-Prishtinë do të organizohet debat publik nga kompania “Granit” Sh.p.k Istog, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e betonit në Suhadoll, Graçanicë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

<https://us04web.zoom.us/j/73446042713?pwd=WEtvcTIOM Ss1NUIMZGsyQVllQm5Zdz09>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Granit” Sh.p.k Istog, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e Asfaltit në Suhadoll, Graçanicë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 04.08.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant pizzeria “Hib Petrol” te rrethi QMI në anën e djathtë të rrugës Lipjan-Prishtinë do të organizohet debat publik nga kompania “Granit” Sh.p.k Istog, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e Asfaltit në Suhadoll, Graçanicë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

<https://us04web.zoom.us/j/76558113713?pwd=REtOazJOOH FuTXVMd0lVdkdOdStzQT09>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Lirigzoni” Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për thërrmimin dhe seperacionin e andeziteve në Kçiq i Madh, Mitrovicë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 04.08.2020 në ora 13:30 në hapësirat e restorant pizzeria “Hib Petrol” në Shupkoc, Mitrovicë do të organizohet debat publik nga kompania “Lirigzoni” Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për thërrmimin dhe seperacionin e andeziteve në Kçiq i Madh, Mitrovicë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

<https://us04web.zoom.us/j/73446042713?pwd=WEtvcTIOMSs1NUIMZGsyQVllQm5Zdz09>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “Gërguri” Sh.p.k Bardh i Madh, Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e gurit gëlqeror në Bardh i Madh, Fushë Kosovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 04.08.2020 në ora 09:30 në hapësirat e restorant “Bistro Bar” në Bardh i Madh rruga Sllatin-Drenas do të organizohet debat publik nga kompania “Gërguri” Sh.p.k Bardh i Madh, Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e gurit gëlqeror në Bardh i Madh, Fushë Kosovë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

<https://us04web.zoom.us/j/73446042713?pwd=WEtvcTIOMSs1NUIMZGsyQVllQm5Zdz09>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

